

KNUT HAMSUN

ZGJIMI I TOKËS

ROMAN

BOTIMET TOENA

KNUT HAMSUN

ZGJIMI I TOKËS

roman

Fitues i Çmimit Nobel

Përktheu Amantia Kapo

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2020

Autori: Knut Hamsun (Knjut Hamsën)

Titulli në origjinal: *Markens Grøde*

Ky përkthim u publikua me mbështetjen financiare të NORLA-s.



Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-277-98-5

© 1917 Gyldendal Norsk Forlag AS

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

PJESA E PARË

1

Shtegun e gjatë, të gjatë, mes kënetave dhe pyjeve - kush e ka shkelur para të gjithëve? Burri, një qenie njerëzore, që erdhi këtu i pari. Nuk kishte asnjë shteg para se ai të vinte në këto vise. Më pas, ndonjë kafshë, duke ndjekur gjurmët e zbehta, në shkurrishte dhe kënetë, i thelloi ato edhe më tepër. E pas tyre disa laponë, duke kërkuar udhën e drerëve, ndoqën shtegun dhe morën rrugën nga fusha në fushë, në kërkim të drerëve. Kështu u krijua rruga përmes Almeningut të madh, kjo tokë e pafundme, që nuk i përkiste askujt, kjo tokë e pazot.

Burri erdhi, duke ecur drejt veriut. Mbante një thes, thesin e tij të parë, ku kishte ushqim dhe disa pajisje. Ishte i fortë dhe me pamje të ashpër, me mjekër të kuqërremtë dhe plagë të vogla në fytyrë dhe duar; shenja të plagëve të vjetra - dëshmitare të punës apo përlëshjeve? Ndoshta burri kishte qenë në burg dhe po kërkonte një vend për t' u fshehur; apo ndoshta ishte një filozof, në kërkim të paqes: sidoqoftë kështu erdhi, qenia njerëzore, mes kësaj vetmie të madhe. Ecën e ecën. Zogjtë dhe kafshët e kësaj toke janë rreth tij; herë pas here shqipton një a dy fjalë; duke folur me vete. “Eh, mirë, mirë”. Aty-këtu, ku kënetat i lënë

vendin një toke më mikpritëse, një hapësire të hapur në mes të pyllit, ai ul thesin dhe shkon për të eksploruar; pas njëfarë kohe kthehet, e hedh thesin përsëri në kurriz dhe vazhdon rrugën. Kështu vazhdon gjatë gjithë ditës. Vështron diellin tek perëndon, natën që bie, e shtrihet mbi shqopa me ballin e mbështetur mbi njërin krah.

Pak orë pushim, dhe ai vihet përsëri në lëvizje: “Eh, mirë...” - duke ecur përsëri drejt veriut, vështron perëndimin e diellit; pushon pak duke ngrënë një vakt me bukë elbi dhe djathë dhie, pi ujë nga përroi dhe përsëri merr rrugën. Edhe këtë ditë ai udhëton, sepse ka shumë gjëra në pyll për t’u eksploruar. Çfarë po kërkon? Një vend, një copë tokë? Ndoshta është një emigrant. Ai i bën sytë katër, dhe nganjëherë, për të vëzhguar më mirë, ngjitet në majë të një kodre. Dielli perëndoi edhe këtë herë.

Burri ecën përgjatë anës perëndimore të një lugine; tokë e pyllëzuar, me aroma të shumëllojshme, me pemë me gjelbërim të përhershëm e lëndina. Orët kalojnë, dhe muzgu bie, por veshi i tij kap gurgullimën e lehtë të një përroi që rrjedh, dhe kjo e qetëson, si të ishte zëri i një gjallese. Ai ngjitet në shpatin e kodrës dhe sheh luginën gjysmë në errësirë, përtej, drejt horizontit, qiellin në drejtim të jugut. Burri shtrihet për të pushuar.

Mëngjesi i shpalos një varg kullotash dhe pyjesh. Ai zbret shpatin e gjelbër. Shumë më poshtë dallohet pasqyrimi i përroit dhe një lepur, që kapërcen përtej me një të hedhur të shpejtë. Burri anon kokën dhe vë re, i kënaqur, që shtrati nuk është aq i gjerë, aq sa një lepur mund ta kalojë me një kërcim. Një thëllëzë, ulur në fole për të ngrohur vezët, ngrihet në

fluturim duke lëshuar një zhurmë të zemëruar dhe ai përsëri anon kokën i kënaqur nga ky takim me shpendin me pendë. Ecën përmes shkurreve të manaferrave dhe boronicave, që mbulojnë tokën; fierit dhe luleve të pyllit. Ndalon, gërmon me një mjet hekuri, dhe gjen myshk të mirë, ose tokë torfë, të prodhuar nga druri i kalbur dhe gjethet e rëna prej një mijë vjetësh. Burri vendos, duke thënë se ka gjetur një vend për të qëndruar dhe jetuar: ai do të qëndrojë këtu dhe do të jetojë. Dy ditë rresht eksploron gjithë vendin, por çdo mbrëmje kthehet te lëndina dhe shtrihet mbi bar. Tashmë, këtu ai ndihet në shtëpi, me një shtrat mbi shkëmb.

Më e vështira kishte qenë të gjente vendin; vendin që nuk i përkiste askujt veçse atij. Tani, kishte punë për të mbushur ditët e tij. Ai filloi menjëherë, duke zhveshur lëvoren e pemëve në pyllin përreth, dhe, ndërkohë që rrëshira rridhte ende, i presoi dhe i vuri të thaheshin. Pasi kishte mbledhur një ngarkesë të rëndë, ai e zbriti në fshat, duke bërë kilometra të tëra rrugë, për ta shitur si lëndë për ndërtim. Pastaj u kthye përsëri në lëndinë, me thasë të rinj mbi kurriz me ushqime dhe pajisje; miell dhe mish derri, një tenxhere gatimi, një lopatë. Bëri disa vajtje e ardhje të tilla përgjatë rrugës që kishte ardhur fillimisht, duke mbajtur ngarkesa gjatë gjithë kohës. Një bartës i lindur ngarkesash, një makinë e lëshuar në pyll, ja ç' ishte: shkelte rrugë të gjata dhe mbante barra të rënda; sikur jeta pa ngarkesë mbi shpatulla të ishte një gjë e mjerueshme, një jetë e plogësht për të, gjithçka e kundërt.

Një ditë ai u kthye me më shumë ngarkesa; solli dy dhi dhe një cjan. Ndihej krenar për dhitë e tij, sikur të ishin një tufë lopësh, e i trajtonte me dashamirësi. I huaji i parë që

kaloi aty, një lapon nomad, kur pa dhitë kuptoi se ishte një njeri që kishte ardhur për të qëndruar. I tha:

- Do të jetosh këtu për gjithmonë?

- Po, - tha burri.

- Si e ke emrin?

- Isak. Njeh ndonjë grua që mund të vijë dhe të më ndihmojë?

- Jo. Por unë do t'u them një fjalë të gjitha grave që takoj.

- Bëje. Kam bagëti këtu dhe askënd për t'u kujdesur për to.

Isak?... Po, laponi do të fliste për të. Burri në lëndinë nuk ishte i arratisur; ai ia kishte thënë emrin e tij. Një i arratisur? Jo, do ta kishte tradhtuar veten në një mënyrë. Ai ishte vetëm një punëtor i zellshëm: përgatiste e priste foragjeret për dimër për dhitë e tij, pastronte tokën, lëronte arën, zhvendoste gurë për të ngritur një mur. Në vjeshtë ai kishte ndërtuar një shtëpi për vete, një kasolle me baltë të trashë, të fortë dhe të ngrohtë; stuhitë nuk mund ta tronditnin dhe asgjë nuk mund ta digjte. Këtu ishte në shtëpinë e tij; ai mund të hynte, të mbyllte derën dhe të qëndronte brenda; mund të qëndronte jashtë në pragun e derës, si pronari i asaj shtëpie, nëse ndonjë njeri do të kalonte aty. Në kasolle kishte dy dhoma; një për veten e tij në një anë, dhe për kafshët në anën tjetër. Hangarin e kishte bërë nën shkëmb. Gjithçka që i nevojitej ishte aty.

Dy burra të tjerë kaluan aty, atë e bir. Ndaluan duke mbështetur të dyja duart mbi bastunët e tyre të gjatë, e vështruan kasollen dhe terrenin e sistemuar, ndërkohë që dëgjonin tingullin e këmborëve të dhive lart në kodër.

- Mirëdita! - i thanë ata.

- Qenkeni sistemuar më së miri këtu. Laponët flasin në këtë mënyrë, me fjalë lajkatare.

- Njihni ndonjë grua që mund të më ndihmojë? - i pyeti Isaku, duke menduar gjithmonë, vetëm një gjë.

- Grua për të të ndihmuar? Jo. Por ne do të themi një fjalë përreth.

- Ju lutem bëjeni. Se unë kam një shtëpi, pak tokë këtu dhe dhi, por asnjë grua për të më ndihmuar.

Oh, ai kishte kërkuar një grua që t'i vinte në ndihmë sa herë që kishte zbritur në fshat, por nuk kishte gjetur. Një e ve apo dy-tri beqare në moshë, i ishin afruar, por nuk kishin pranuar të angazhoheshin për ta ndihmuar. Përse? Isaku nuk mund ta kuptonte përse. Nuk e kuptonte vërtet? Kush do të pranonte t'i shërbente një burri të vetëm në një pyll të shkretë, me mijëra kilometra larg - një udhëtim që të merrte gjithë ditën për të arritur banesën më të afërt? Dhe burri vetë nuk ishte aspak simpatik apo i këndshëm nga pamja; dhe kur fliste nuk ngjante aspak me një tenor me sytë nga qielli; zëri i tij ishte i ashpër, theksi, brutal.

E po, ai do të duhet të dorëzohej e të jetonte vetëm!

Dimri erdhi, ai preu copa të mëdha druri dhe i shiti me leverdi në fshat, dhe në kthim, përsëri nëpër dëborë, duke mbajtur në kurriz thasë me ushqime dhe vegla pune; ditët më të vështira ishin ato kur i duhej të tërhiqte ngarkesën nëpër borë. Meqenëse kishte dhi, dhe askënd për t'u kujdesur, burri nuk mund të qëndronte larg për një kohë të gjatë. Dhe çfarë bëri? Nevoja e bëri atë të mençur; truri i tij ishte i fortë dhe pak i përdorur; ai e stërviti atë gjithnjë e

më shumë. Mënyra e tij e parë ishte që të linte dhitë të lira para se të largohej, në mënyrë që të mund të ushqeheshin mirë në mes të bimëve në pyll. Por i lindi edhe një ide tjetër. Ai mori një kovë të madhe dhe e vari pranë lumit. Që të mbushej pak nga pak, duheshin gjithsej katërmbëdhjetë orë. Kur ishte plot deri në buzë, pesha ishte aq e madhe sa kova zhytej, duke tërhequr pas vetes një litar, i cili hapte një derë të vogël nga ku binin tufa me foragjere për të ushqyer dhitë.

Kjo ishte zgjidhja e tij.

Një ide e shkëlqyer; një frymëzim, ndoshta, i dërguar nga Zoti. Burri nuk kishte asnjë që ta ndihmonte, por vetëm vetveten. Kjo i shërbeu nevojës së tij deri vonë në vjeshtë; pastaj erdhi dëbora e parë, pastaj shiu, pastaj përsëri bora, gjatë gjithë kohës. Dhe mekanizmi i tij u çrregullua; kova filloi të mbushej duke hapur kurthin shumë shpejt. Ai fiksoi një kapak dhe kështu mundi të vazhdonte për një kohë; pastaj erdhi dimri, uji ngriu dhe e ndaloi mekanizmin përfundimisht.

Isaku nuk lexonte libra, por mendimet e tij ishin shpesh me Perëndinë; për jetën e pëртејshme, ishte e natyrshme, sepse kishte një shpirt të thjeshtë dhe të ndrojtur. Yjet në qiell, era në pemë, vetmia dhe dëbora e përhapur, fuqia e tokës dhe e hapësirës e shtynin atë të mendohej e të lutej. Ai ishte një mëkatar dhe kishte frikë nga Zoti; të dielave lahej për të nderuar ditën e shenjtë, por nuk qëndronte pa punuar më pak se gjatë javës.

Erdhi pranvera; ai punoi tokën dhe mbolli patate. Tufa e tij u shumua; të dyja dhitë bënë secila binjakë, duke u bërë tashmë shtatë. Zgjeroi stallën për shtim të mëtejshëm, dhe

vendosi edhe xhama, duke e bërë më të bukur dhe më të ndritshme.

Dhe, më në fund, erdhi edhe ndihma; gruaja që i duhej.

Ajo u soll vërdallë një kohë të gjatë, e para se të merrte përsipër të prezantohej, priti derisa ra mbrëmja. Ishte një vajzë e madhe, me sy kaf, trupngjeshur dhe aspak fine, me duar të mëdha; mbathur me çizme prej lëkure të papërpunuar, si një lapone, dhe mbi supe kishte hedhur një lëkurë deleje. Jo krejt e re në moshë.

Nuk kishte asgjë për t'u frikësuar; ajo e përshëndeti dhe i tha me ngut:

- Po kaloja kodrat dhe ndalova këtu.

- Vërtetë, - tha burri. Ai mezi kuptonte se ç'i thoshte e sapoardhura, sepse ajo fliste duke i ngrënë fjalët dhe e mbante kokën mënjanë.

- Po, - tha ajo, - është një rrugë e gjatë për të ardhur.

- Pra, erdhe nga kodrat?

- Po.

- Dhe pse?

- Kam njerëzit e mi atje.

- Ah, kështu pra, ke familjen atje? Dhe si ta thonë emrin?

- Inger. Po ty?

- Isak.

-Isak? Dhe jeton vetëm këtu?

- Po, vetëm, këtu siç e sheh.

- Pse, nuk është dhe aq keq, - tha ajo për t'i bërë qejfin.

Filloi të kuptonte, më në fund. Gruaja kishte ecur dy ditë për të ardhur aty. Ndoshta ajo kishte dëgjuar për dëshirën e tij që të gjente një grua për ta ndihmuar.

- Eja brenda dhe pusho pak, - tha ai.

Ata hynë në kasolle dhe hëngrën një pjesë të ushqimit që ajo kishte sjellë me vete, dhe pinë qumështin e dhive të tij; pastaj bënë kafënë, që ajo e kishte sjellë me vete në një enë. U vendosën të qetë derisa erdhi ora e gjumit.

Natën, ai e dëshiroi dhe ajo ishte e gatshme.

Ajo nuk u largua në mëngjes; qëndroi gjatë gjithë ditës, e ndihmoi për shtëpinë; moli dhitë, pastroi enët me rërë. Ajo nuk u largua më.

Inger ishte emri i saj. Dhe Isak ishte emri i tij.

Dhe, tani, për njeriun e vetmuar filloi një jetë tjetër. Tashmë ajo, që ishte gruaja e tij, kishte një mënyrë të foluri të shkëputur e të çuditshme, dhe gjithmonë e kthente fytyrën mënjanë, për shkak të buzëlepurit, por kjo nuk kishte rëndësi. Po të mos e kishte gojën e shpërfytyruar, vështirë se do të kishte vajtur deri tek ai; ai mund të ishte mirënjohës që ajo kishte një buzëlepuri. Po ai vetë, ishte pa defekte? Me mjekrën e shpupurishur edhe trupin e madh, ai ishte një personazh i frikshëm; një pasqyrim i deformuar i shfaqur në një pasqyrë. E për sa u përket tipareve të fytyrës së tij, ato të bënë të mendoje për një Barrabas, që mund të shfaqej nga një çast në tjetrin. Ishte një çudi që Ingeri nuk ia mbathi kur e pa.

Ajo nuk iku. Kur ai u largua dhe u kthye përsëri në shtëpi, Ingeri ishte në kasolle; gruaja dhe kasollja ishin bërë një tashmë.

Ishte një gojë tjetër për t'u ushqyer, por pa humbje në këtë pikë; ai kishte më shumë liri tani, dhe mund të shkonte e të qëndronte ashtu siç duhej. Dhe kishte gjëra që duheshin

parë larg shtëpisë. Ishte lumi; i këndshëm për t'u parë, dhe i thellë e i shpejtë; një lumë për të mos u përçmuar; duhej të buronte lart nga kodra. Ai mori me vete disa pajisje peshkimi dhe shkoi të eksploronte; në mbrëmje u kthye me një shportë mbushur me trofta. Kjo ishte një gjë e shkëlqyer për Ingerin, një mrekulli; ajo ishte e mërzitur, duke mos qenë aspak në gjendje të gatuante gjellë. Ajo përplasi duart me gëzim dhe bërtiti:

- Je i pashoq!

Gruaja e kishte kuptuar që ai ishte i ndjeshëm ndaj komplimenteve të saj, ndaj shtoi edhe të tjera: ajo nuk kishte parë ndonjëherë një peshkim kaq të bollshëm, madje aq sa pyeste veten sesi ishte e mundur.

Ingeri ishte gjithashtu një shoqe e çmuar. Nuk ishte shumë e zgjuar dhe as e mrekullueshme, por ajo zotëronte, në kopenë e familjes së saj, dy dele, që priteshin të lindnin dy qengja, ndaj ajo zbriti për t'i marrë ata. Ishte më e mira që ata mund të kishin dëshiruar në kasollen e tyre: dele me lesh dhe qengja, katër kokë dhen për kopenë e tyre. Ingeri solli më shumë gjëra; rroba, dhe sende të vogla të saj, një pasqyrë, një varg të bukur me perla prej qelqi, rruaza, një rrotë tjerrëse dhe një krehër. Nëse ajo do të vazhdonte me këtë ritëm kasollja do të mbushej shpejt nga dyshemeja deri në çati dhe nuk do të mbetej as edhe një copë vend!

Isaku, nga ana e tij, u mahnit nga e gjithë kjo pasuri, por duke qenë një njeri i heshtur dhe i ngadalshëm në të folur, ai nuk tha asgjë, vetëm doli në prag, shikoi motin, dhe u fut brenda përsëri. Ai kishte qenë, me të vërtetë, me fat; ndihej

gjithnjë e më shumë i dashuruar, ose i tërhequr prej saj, ose çfarëdo që të ishte.

- Nuk ke pse sjell më gjëra, - tha ai. - Ka më shumë sesa duhet.

- Kam akoma, madje është edhe xhaxha Siverti, përveç të tjerëve. Ke dëgjuar për të?

- Jo.

- Ai është i pasur dhe punon si arkëtar i gjithë qarkut.

Dashuria bën një budalla të mençur. Isaku mendonte se duhej të bënte diçka madhështore vetë, dhe e teproi.

- Atë po të thosha; nuk ke nevojë të shqetësohesh për të mbjellë patatet. Do ta bëj vetë në mbrëmje, kur të kthehem në shtëpi.

Mori sëpatën e tij dhe iku në pyll.

Ajo e dëgjoi duke prerë dru në pyll, jo larg; arrinte të kuptonte nga përplasja e sëpatës se ai ishte duke prerë trungje të mëdha. Atëherë, doli në fushën e patateve dhe filloi të mbillte. Dashuria i bën budallenjtë të mençur.

Isaku u kthye në shtëpi në mbrëmje, duke tërhequr një trung të madh me një litar. Oh, ai Isaku i thjeshtë dhe i pafajshëm, bëri tërë zhurmën që mundi me pemën që tërhiqte, u kollit e pështyu, bëri gjithçka që ajo të dilte dhe të habitej prej fuqisë së tij.

- Oh, - tha ajo teksa doli në prag, - a është kjo punë për një burrë të vetëm?

Ai nuk i dha asnjë përgjigje; të bëje pak më shumë punë sesa të ishte e mundur për një burrë të vetëm, ishte një gjë që nuk ia vliente të shtjellohej.

- Dhe çfarë do të bësh me të? - e pyeti Ingeri.

- Oh, do të shohim, - u përgjigj ai i shkujdesur.

Por, kur pa që ajo kishte mbjellë patatet, në fund të fundit, ai nuk ishte i kënaqur. Ishte sikur ajo të kishte bërë po aq sa ai; dhe kjo nuk i shkonte për shtat. Zgjidhi litarin nga trungu i pemës dhe u largua me të edhe një herë.

- Do të shkosh sërish? - e pyeti ajo.

- Po, - tha ai me zemërim.

U kthye me një trung tjetër, vetëm, pa zhurmë dhe pa shfryrë; e tërhiqte si një ka.

Atë verë, ai tërhoqi shumë trungje deri në kasolle.

2

Një ditë Ingeri paketoj disa ushqime në çantën e saj prej lëkurë deleje dhe tha:

- Do të shkoj për të parë njerëzit e mi.

- Pse, - e pyeti Isaku.

- Më duhet të flas pak me ta për disa gjëra.

Isaku nuk doli menjëherë jashtë për ta shoqëruar, por qëndroi i mbytur në mendime. Dhe kur, më në fund, doli te pragu, duke mos pasur aspak ankth, apo frikë, Ingeri ishte larg, po futej tashmë në pyll.

- Hëm! A do të kthehesh ndoshta? - nuk u përmbajt pa thirrur.

- Të kthehem? Pse, çfarë të shkon nëpër mendje? Sigurisht që do të kthehem.

Kështu që ai mbeti përsëri vetëm - “eh, mirë, mirë!”... Me forcën e tij dhe dashurinë që kishte për punën, ai nuk mund të rrinte duarkryq brenda dhe jashtë kasolles duke mos bërë asgjë; vendosi të pastrojë lëndën drusore dhe ta presë në të dyja anët. Punoi gjatë gjithë ditës, pa harruar të milte dhitë, dhe pastaj shkoi në shtrat.

Sa e zhveshur dhe bosh ishte tani kasollja; një heshtje e rëndë mbretëronte rreth mureve prej balte dhe dyshemesë

prej dheu; një vetmi e thellë dhe solemne. E megjithatë krehri dhe rrotulla e tjerres ishin në vendin e tyre; rruzat gjithashtu ishin të sigurta siç kishin qenë, të ruajtura në një çantë nën çati. Ingeri nuk kishte marrë asgjë nga gjërat e saj. Por Isaku ishte budalla, ishte i frikësuar nga errësira në netët e lehta të verës; i dukej sikur shihte hije që kalonin para dritares. Zgjohej para agimit dhe hante mëngjesin e tij, një pjatë plot me qull për ta mbajtur gjatë ditës dhe për të kursyer kohë në gatime të kota.

Tri ditë me radhë ai punoi me lopatë dhe sëpatë; Ingeri do të kthehej me siguri të nesërmen. Nuk do të ishte keq të përgatiste një pjatë peshku për të kur të vinte - por rruga e drejtë për nga lumi shtrihej po andej nga do të vinte ajo... Kështu që ai devijoi në një rrugë më të gjatë; një rrugë të re, mbi kodrat ku ai nuk kishte qenë kurrë më parë. Shkëmbinj ngjyrë kafe dhe gri, gurë të rëndë po aq të rëndë sa bakri ose plumbi. Këta gurë të rëndë mund të përmbanin lëndë me vlerë; ar ose argjend, kushedi! Isaku nuk kishte njohuri për gjëra të tilla dhe nuk i interesonte. Mbërriti buzë ujit; mizat mbushnin ajrin dhe peshqit kafshonin karremin lehtshëm atë natë. Ai do të çonte në shtëpi një shportë të mbushur aq plot me peshq, saqë Ingeri do të shqyente sytë nga habia! Duke u kthyer përsëri në mëngjes nga rruga që kishte ardhur, ai mori disa prej gurëve të vegjël të kodrave; ishin ngjyrë kafe, me pika blu të errët aty-këtu, dhe tejet të rëndë në dorë.

Ingeri nuk ishte kthyer, dhe nuk erdhi as atë ditë. Kjo ishte dita e katërt. Ai moli dhitë siç kishte bërë kur kishte jetuar vetëm dhe nuk kishte dikë tjetër që ta ndihmonte; pastaj u

ngjit afër një guroreje dhe preu blloqe të shkëlqyeshme dhe të zgjedhura me kujdes për të ndërtuar një mur. Ai ishte pa fund i zënë me punë.

Mbrëmjen e pestë, ai u kthye për të pushuar me një frikë të vogël në zemër - por sendet e Ingerit ishin gjithnjë aty. Kasollja ishte mjerisht e zbrazët dhe e zhveshur, pa as edhe një tingull; orët ishin të gjata dhe kur, më në fund, dëgjoi diçka si një tingull hapash jashtë, ai mendoi se ishte duke ëndërruar. “Oh, Perëndi”, murmuriti ai, në vetminë e tij. Isaku nuk ishte nga ata që fliste pa u menduar. Dëgjoi përsëri hapa jashtë dhe, një moment, pa diçka që kaloi para dritares; diçka me brirë, diçka e gjallë. U ngrit dhe doli te pragu i derës; dhe ja, një vegim! “Zoti apo djalli”, mërmëriti Isaku, i cili nuk i nxirrte fjalët pa u menduar. Ai pa një lopë; Ingerin dhe një lopë, duke u zhdukur brenda në stallë.

Nëse nuk do të kishte qëndruar atje vetë dhe të kishte dëgjuar Ingerin duke folur butësisht me lopën - nuk do ta besonte. Por ai ishte aty. Dhe, papritur, i lindi një dyshim i urryer. Zoti e bekoftë! Natyrisht, ishte një grua e mrekullueshme, por ekzagjerimi mbetet ekzagjerim. Rruazat dhe rrotullën mund dhe t’i kuptonte, megjithëse ishin shumë të bukura për t’u pasur në çfarëdo mënyre të përshtatshme dhe të natyrshme. Por një lopë, e gjetur në rrugë, mbase, ose në një fushë - pronari do ta kërkonte dhe do të ndiqte gjurmët e tyre.

Ingeri doli jashtë, duke përmbajtur një të qeshur të vogël, dhe tha me krenari:

- Unë jam dhe kam sjellë me vete lopën time.

- Hëm, - tha Isaku.

- Kjo më bëri që të vonohem kaq gjatë, nuk mund të ecja më shpejt me të nëpër kodra.

- Dhe kështu ke sjellë një lopë? - tha ai.

- Po, - tha ajo, e fryrë nga gjithë kjo pasuri. - Apo të duket si një shaka, ndoshta?

Isaku kishte frikë nga më e keqja, por nuk e dha veten dhe vetëm tha:

- Eja brenda dhe merr diçka për të ngrënë.

- A e pe? A nuk është një lopë e bukur?

-Po, një lopë e mirë, - tha Isaku. Dhe duke vazhduar me shumë kujdes, ai e pyeti: - Ku e more?

- Quhet Briartë. Për çfarë duhet ai mur që ke ndërtuar këtu? Do të punosh deri në vdekje? Oh, tani eja të shohësh lopën.

Ata dolën për ta parë dhe Isaku ishte me këmishë, por kjo nuk kishte rëndësi. Ata vështruan lopën me kujdes, në çdo pjesë të trupit, dhe shënuan të gjitha larat e kokës dhe shpatullave, mollaqeve dhe kofshëve, ku ishin të kuqe dhe të bardha, dhe si ishin të vendosura.

- Sa vjeçe mendon se mund të jetë? - e pyeti Isaku me kujdes.

- Mendoj? Pse, ajo është saktësisht në vitin e saj të katërt. E kam rritur vetë dhe të gjithë thanë se nuk kanë parë ndonjëherë një lopë më të mirë. Por a do të ketë ushqim sa duhet këtu?

Isaku filloi të besojë, pasi ai ishte shumë i gatshëm për ta bërë këtë.

- Sa për ushqimin, do të ketë mjaftueshëm, kurrë mos ki frikë.

Pastaj shkuan në kasolle për të ngrënë dhe pirë e për të kaluar një mbrëmje së bashku. Kur u shtrinë në shtrat ata vazhduan të flisnin për lopën; një ndodhi e rëndësishme në jetën e tyre.

- Një lopë e mirë, eh? E për më tepër është me barrë. Dhe quhet Briartë. Po fle gjë? Isak?

- Jo.

- Ajo më njohu përsëri; më njohu menjëherë dhe më ndoqi si një qengj. Pushuam pak në kodra natën e kaluar para se të vinim këtu. Por ajo do të duhet të jetë e lidhur gjatë gjithë verës, sepse do t'ia mbathë. Një lopë mbetet një lopë.

- Ku ka qenë më parë? - e pyeti Isaku, më në fund.

- Me prindërit e mi, ata e kishin. Dhe ndjenë keqardhje për humbjen e saj, madje të them, se të vegjlit qanin kur unë e mora.

A ishte e mundur që ajo të gënjente kaq bukur? Jo, nuk ishte e mundur, duhet të jetë e vërtetë, lopa ishte e saja, sepse ajo e pohonte me kaq vërtetësi.

Eh, ata po shihnin begati në këtë kasollen e tyre, në këtë fermën e tyre. Ishin aq mirë, sa gjithçka që mund të dëshironin e kishin tashmë.

Oh, Ingeri; ai e donte atë dhe ajo e donte; kënaqeshin me pak, jetonin thjesht dhe ishin të lumtur!

- Le të flemë! - thanë dhe shkuan për të fjetur.

Kur do të zgjoheshin të nesërmen në mëngjes, për një ditë të re pune, shumë gjëra të tjera do t'iu shtoheshin. Puna

do të ishte e lodhshme. Por ata ishin të lumtur. Herë lodhje, herë kënaqësi: kjo është jeta.

Si për shembull, ato trungjet e drurit që i kishte pastruar, a nuk duhej vallë t'i përdorte për ndërtim? Isaku kishte parë kur zbriste në fshat se si i përdornin për ndërtim; ai mund të ndërtonte vetë, pse jo? Për më tepër, ishte e nevojshme dhe duhej të bëhej. A nuk kishin tashmë një fermë me dele, me lopë, dhi, që ishin shumë, dhe që do të shtoheshin akoma? Ndarja ndërmjet stallës dhe kasolles rrezikonte të shembej; diçka duhej bërë. Dhe më mirë ishte t'i përvishesh punës menjëherë, ndërkohë që patatet ishin akoma me lule, dhe nuk ishte stina e korrjeve. Ingerit do t'i duhej ta ndihmonte duke i dhënë një dorë aty-këtu.

Isaku u zgjua natën dhe u çua. Ingeri ishte në një gjumë të thellë pas rrugës së saj të gjatë. Shkoi në stallë për të parë lopën. Tashmë, ai nuk i foli lopës me zë përçmues; e përkëdheli dhe e vështroi me vëmendje përsëri në çdo pjesë të trupit, për të parë nëse, rastësisht, do të dallonte ndonjë shenjë të përkatësisë së ndonjë pronari. Asnjë shenjë, dhe Isaku u shtri në shtrat i lehtësuar.

Trungjet shtriheshin aty, ai iu përvesh punës duke i rrokullisur, duke i ngritur. I vendosi në mur duke krijuar një kornizë; një kornizë e madhe sallonin, dhe një të vogël për dhomën e gjumit. Ishte punë e rëndë, punë me frymëmarrje të fortë dhe mendja e tij ishte e tëra e përpirë nga kjo punë, saqë harroi kohën që kalonte. Një shtëllungë tymi doli nga vrima e çatisë së kasolles; Ingeri hapi derën dhe lajmëroi që mëngjesi ishte gati.

- Me çfarë po merresh tani? - pyeti ajo.

- Qenke zgjuar, - tha Isaku, dhe kjo ishte gjithçka si përgjigje.

Isakut i pëlqenin pyetjet kureshtare mbi planet e tij. Ai hëngri pak dhe u ul për ca kohë në kasolle para se të dilte përsëri. Çfarë priste?

- Nuk mund të rri këtu pa punë, kur kam kaq shumë për të bërë.

- Duket sikur po ndërton një shtëpi, - tha Ingeri. - Pse nuk do të më përgjigjesh?

Dhe ai denjoi e iu përgjigj, ky njeri i madh që do t'i ndërtonte të gjitha vetë.

- Po ti e sheh dhe vetë.

- Po... Po, natyrisht.

- Është diçka që nuk mund të presë më. Ti sjell një lopë të mbarsur, të cilës i duhet një stallë.

E varfra Inger, nuk ishte aq e mençur sa ai, sa Isaku, krijuesi; por kjo ishte përpara se ajo të mësonte ta njihnte mirë atë dhe të merrte parasysh mënyrën e tij për të vendosur gjërat. Ingeri iu përgjigj:

- Po kjo që po ndërton, nuk është një stallë.

- Eh, - tha ai.

- Mendoj se po ndërton një shtëpi.

- Mendon kështu vërtet? - ia ktheu Isaku, duke marrë një pamje sikur të mos e kishte menduar kurrë në jetë këtë gjë.

- Po. Dhe kafshët do t'i vendosim në kasolle?

Isaku u mendua pak.

- Ej, mbase do të ishte më mirë.

- E sheh, - ia ktheu Ingeri, e lumtur dhe triumfuese. - E sheh që unë jam e mirë për diçka.

- Është e vërtetë. Dhe çfarë do të thuash për një shtëpi me dy dhoma brenda?

- Dy... dhoma? Oh!... Pse, s' do të jesh njësoj si njerëzit e tjerë. A mendon se mundemi?

Po, ata mundeshin dhe Isaku shkoi të ndërtojë, duke ngulur shtyllat dhe duke përshtatur kornizën. Gjithashtu, ai krijoi një vatër me gurë të zgjedhur, megjithëse kjo e fundit ishte e mundimshme, Isaku nuk ishte i kënaqur me punën e tij. Koha e korrijeve erdhi, dhe ai u detyrua ta linte ndërtimin dhe të shkonte rreth e përqark kodrave larg dhe afër, për të kositur barin dhe për ta sjellë në kurriz deri në shtëpi.

Një ditë me shi ai zbriti në fshat.

- Çfarë do të bësh në fshat?

- E po, nuk mund të ta them saktësisht akoma...

Ai u nis, dhe qëndroi dy ditë. U kthye me një sobë gatimi - si një varkë që ngjitej nëpër pyll me një sobë hekuri mbi shpinë.

- Bën më shumë sesa mund të bëjë një njeri, - i tha Ingeri.

Isaku prishi vatrën prej guri, që nuk dukej aq mirë në shtëpinë e re dhe vendosi furrën e gatimit në vend të saj.

- Jo të gjithë kanë një sobë gatimi, - tha Ingeri. - Po bëhemi njerëz të rëndësishëm.

Korrja vazhdonte ende; Isaku sillte ngarkesa të mëdha, sepse bari pyjor nuk është njësoj si bari i livadhit. Tashmë vetëm në ditët me shi ai mund të gjente kohë për ndërtimin e tij; dhe nuk po përparonte aspak. Madje deri në gusht, kur kishte sistemuar barin nën strehën e shkëmbit, shtëpia e re ishte akoma gjysmë e mbaruar. Në shtator Isaku deklaroi se nuk po ia dilte dot.

- Më mirë ik deri në fshat dhe gjej një burrë për të më ndihmuar.

Ingeri kishte qenë pa qejf kohët e fundit dhe nuk vraponte shumë, por gjithsesi ajo u bë gati për të shkuar.

Por Isaku kishte ndryshuar përsëri mendje; kishte marrë sërish mënyrën e tij madhështore dhe i tha që ai do ta përfundonte vetë, sedra e tij fshatarake ishte prekur.

- S'është e nevojshme të bezdisim dynjanë, do ta mbaroj vetë.

- Nuk do t'ia dalësh dot. Do të lodhesh.

- Vetëm më ndihmo t'i ngre këto, - tha Isaku, dhe kjo ishte e gjitha.

Erdhi tetori dhe Ingeri tha se i duhej të hiqte dorë. Kjo ishte një goditje e fortë, sepse trarët e çatisë duhej të ngriheshin me çdo kusht, dhe vendi duhej mbuluar para shiut të vjeshtës; nuk kishte një ditë për të humbur. Çfarë nuk shkonte me Ingerin? Mos do të sëmurej? Ajo bënte djathë nga qumështi i dhive, por përtej kësaj, ajo vetëm tundte shkopin e Briartës tek e çonte për të kullotur.

- Më sill një shportë të madhe, ose një kuti, herën tjetër kur të zbresësh në fshat, - i kishte thënë ajo.

- Për çfarë e do? - e kishte pyetur Isaku.

- Thjesht më duhet, - i ishte përgjigjur Ingeri.

Isaku lidhte trarët e çatisë me një litar, ndërsa Ingeri i drejtonte me një dorë; ishte një ndihmë vetëm sa për të thënë. Pak nga pak puna përparonte; nuk kishte ndonjë lartësi të madhe në çati, por lënda drusore ishte e madhe dhe e rëndë për një shtëpi të vogël.

Vjeshta ishte mjaft e bukur. Ingeri u mor me patatet, ndërsa Isaku me çatinë para se të fillonte shiu. Kafshët i futën brenda në kasolle dhe të gjithë flinin atje, natën; bënin si të mundnin pa u ankuar.

Isaku u përgatit për një udhëtim tjetër poshtë në fshat. Ingeri iu lut me shumë modesti:

- Mos harro të më sjellësh një shportë me madhësi të mirë, apo një kuti.

- Kam porositur disa dritare xhami, - tha Isaku, - dhe dy dyer të pikturuara. Do të duhet t'i marr, - shtoi ai me mënyrën e tij madhështore.

- Eh mirë, po mendo dhe për shportën.

- Për çfarë e do shportën? Për çfarë është?

- Për çfarë është?... Oh, nuk i ke sytë në ballë!

Isaku u largua i mbytur në mendime. Dy ditë më vonë u kthye, me një dritare dhe një derë për sallonin si dhe një derë për dhomën e gjumit; gjithashtu ai kishte varur rreth qafës përpara një kuti paketimi me madhësi të mirë dhe plot ushqime.

- Do ta sflitësh veten për vdekje një ditë, - i tha Ingeri.

- Oh, vërtet!

Isaku ishte shumë larg nga vdekja; ai nxori nga xhepi një shishe me *naphta* dhe ia dha Ingerit me këshillën që ta merrte rregullisht dhe të bëhej sërish mirë.

Ishin dritaret dhe dyert e pikturuara me të cilat mund të mburrej me të drejtë; ai vendosi t'i përvishej punës menjëherë duke i përshtatur ato. Oh, dyert ishin kaq të vogla dhe të vjetra, por i leu përsëri të gjitha me të kuqe dhe

të bardhë; tani ato e stolisin shtëpinë aq mirë sikur të ishin piktura në mure.

Më në fund, ata u zhvendosën në ndërtesën e re dhe kafshët kishin gjithë kasollen e vjetër. Këto qenie njerëzore në shkretinë e tyre kishin bërë gjëra të mëdha, kishin bërë çudira.

3

Isaku punoi tokën deri para ngricës; hiqte gurë dhe rrënjë që duheshin gërmuar dhe pastruar, që livadhi të rrafshohej e të ishte gati për vitin e ardhshëm. Kur toka u ngurtësua, ai la punën e tij në fushë dhe u bë druvar, duke prerë e prerë sasi të mëdha.

- Për çfarë të duhet i gjithë ky dru? - e pyeti Ingeri.

- Oh, do të jetë i dobishëm në njëfarë mënyre, - tha Isaku, sikur të mos e kishte planifikuar. Por Isaku e kishte një plan. Këtu, pylli i virgjër rritej i dendur, para shtëpisë, si një pengesë për fushat e tij, për të cilat ai donte vend. Për më tepër, duhet të ekzistonte një mënyrë për të zbritur drurin në fshat atë dimër; kishte mjaft njerëz që do të ishin të lumtur të blinin dru për ngrohje. Ishte një plan i mirë dhe Isaku nuk kishte asnjë dyshim; ai vazhdoi punën e tij në pyll, duke prerë pemë dhe duke i bërë gati.

Inger dilte shpesh për ta parë tek punonte. Isaku bënte sikur ardhja e saj të mos kishte rëndësi dhe sikur të mos kishte aspak nevojë për të; por ajo e kishte kuptuar mirë atë. Bisedat e tyre ishin të çuditshme.

- A nuk mund të gjesh gjëra për të bërë, në vend që të dalësh këtu dhe të ngrish së ftohti, - i tha Isaku.

- Nuk kam ftohtë, - iu përgjigj Inger. - Por nuk mund të kuptoj përse punon deri në sflitje.

- Mirë, mirë po merre xhaketën dhe hidhe krahëve.

- Me të vërtetë do ta bëja me shumë qejf, por nuk kam kohë të rri këtu, sepse Briarta është gati për të lindur.

- Si the, gati për të lindur?

- Pse bën sikur nuk e di! Por, çfarë mendon se duhet të bëjmë me viçin. A do ta rrisim?

- Bëj siç mendon; nuk mendoj se do të ishte mirë ta hanim. Prapë do të mbeteshim me një lopë.

- Nuk e kisha çuar kurrë në mendje që do të propozoje të hanim viçin.

Kjo ishte mënyra e tyre. Të shëmtuar, të vetmuar dhe të trashë, por një bekim për njëri-tjetrin, për kafshët dhe për tokën.

Dhe Briarta lindi. Një ditë e shkëlqyer në atë shkretinë, një gëzim dhe një kënaqësi. Ata i dhanë një qull dhe Isaku tha:

- Mos ia kurse miellin.

Dhe ja, tani kishin dhe një viçe të bukur që rrinte shtrirë; një mrekulli, me lara të kuqe si nëna e saj, dhe të befasuar nga mrekullia e ardhjes në botë. Pas dy vjetësh ajo do të kishte viçat e vet.

- Viçja do të bëhet një lopë e shkëlqyer kur të rritet, - tha Ingeri. - Po si do ta quajmë? Nuk kam asnjë ide.

Inger ishte fëmijërore në mënyrat e saj dhe nuk kishte mendje të zgjuar për asgjë.

- Si do ta quajmë? - tha Isaku. - Përveçse Briargjenda, si mundemi ta quajmë ndryshe?

Erdhi dëbora e parë. Sapo u krijua një rrugë të kalueshme, Isaku u nis për në fshat, plot mister, kur Ingeri e pyeti për udhëtimin e tij. Dhe u kthye kësaj here me një surprizë të re dhe të paimagjinueshme. Një kalë, asgjë më pak.

- Është një rreng, - i tha Ingeri. - Apo e ke vjedhur?

- Unë të vjedh?

- E po, e ke gjetur, atëherë?

Ah, sikur të kishte mundësi të thoshte:

- Është kali im, kali ynë...

Por, për të thënë të vërtetën, ai e kishte marrë me qira atë së bashku me karrocën për të transportuar dru.

Isaku zbriti sërish në fshat me drutë për zjarr dhe solli përsëri ushqim, harenga dhe miell. Dhe një ditë erdhi me një dem të ri; e bleu atë për hiç mos gjë, për shkak se në fshat mungonte ushqimi për kafshët. Kafsha ishte e dobët, aspak e hijshme, por solide dhe një ushqim i mirë do ta sillte atë sërish në formë.

- Çfarë po na sjell tjetër? - tha Inger.

Isak solli një mori gjërash. Solli dërrasa dhe një sharrë që ai e kishte marrë në këmbim të lëndës drusore; një gur bluarjeje, vegla - të gjitha në këmbim të drurit për zjarr që kishte prerë. Ingeri ndiente marramendje nga gjithë kjo pasuri dhe thoshte çdoherë:

- Sa shumë gjëra! Kemi bagëti dhe gjithçka që mund të mendojmë!

Ata kishin mjaft për të përmbushur nevojat e tyre për shumë kohë, dhe ishin njerëz të kursyer. Çfarë do të bënte Isaku përsëri pranverën e ardhshme? Ai i kishte menduar të gjitha, duke tërhequr ngarkesat e tij me dru atë dimër; ai do

të pastronte më shumë tokë mbi kodër dhe do ta rrafshonte, drurin e prerë do ta linte për t'u tharë gjatë verës dhe të kishte ngarkesa të dyfishta kur dëborë të binte përsëri. Asgjë nuk ia kishte lënë fatit, gjithçka e kishte llogaritur mirë.

Kishte edhe një çështje tjetër që Isaku e kishte menduar e menduar gjatë: ajo e Briartës, nga kishte ardhur, e kujt ishte? Nuk kishte mbi tokë një grua si Ingeri. Oh, ajo ishte disi e egër, por donte atë çka donte edhe ai, dhe ishte gjithmonë e kënaqur. Por - le të supozonin se një ditë do të vinin për lopën, dhe ta merrnin, kjo do të kishte shumë pasoja. Vetë Ingeri i kishte thënë për kalin:

“E ke vjedhur gjë, apo e gjete?”.

Ky ishte mendimi i parë i saj. A duhej t'i besonte? Çfarë duhej të bënte? Kishte menduar për të gjitha shumë kohë. Dhe ja që i kishte sjellë vetë një bashkëshort për lopën - për një lopë të vjedhur, ndoshta!

Kishte ardhur koha të kthente kalin. Një keqardhje për të, për këtë kafshë miqësore.

- Asnjëherë mos harro se ke bërë mrekulli me të, - tha Ingeri me ngushëllim.

- E di, por kur të vijë pranvera do të kem më shumë nevojë për një kalë...

Mëngjesin tjetër ai u largua i qetë me ngarkesën e fundit. Ditën e tretë u kthye në këmbë, u ndal ndërsa i afrohej shtëpisë, sepse dëgjoji diçka. Kishte një zhurmë të çuditshme brenda... Një fëmijë duke qarë, o Perëndi, po ishte pikërisht kjo. Një gjë e tmerrshme dhe e habitshme. Dhe Ingeri nuk kishte thënë kurrë asnjë fjalë.

Ai u fut brenda, dhe gjëja e parë që pa ishte kutia - kutia e famshme që ai kishte sjellë lidhur rreth qafës, të varur para në gjoks; tashmë ishte e varur në tavan, e transformuar në një djep, një shtrat për fëmijën. Ingeri ishte ngritur, duke ecur gjysmë e veshur - ajo kishte mjelë lopën dhe dhitë, si të kishte qenë thjesht një ditë e zakonshme.

Fëmija ndaloi së qari dhe Isaku e pyeti:

- Kaloi mirë?

- Po.

- Hëm.

- Ndodhi mbrëmjen e parë që ti u largove.

- Hëm.

- U zhvesha dhe do ta varja djepin atje, por ishte shumë për mua, dhe m'u desh të shtrihesha.

- Pse nuk më lajmërove?

- Pse, e dija unë se kur do të vinte? Është një djalë.

- Hëm, një djalë.

- Dhe nuk di fare sesi do ta quajmë, - tha Ingeri.

Isaku vështroi fytyrën e vogël të kuqe; ishte i formuar mirë, pa buzëlepuri dhe me flokë të dendur në kokë. Një i vogël i shëndetshëm duke pasur parasysh gjendjen e tij dhe duke pasur për krevat një kuti! Isaku e ndjeu veten çuditërisht të dobët. Fshatari i pagdhendur qëndronte atje me një mrekulli para tij; një gjë e krijuar para së gjithash në një mjegull të shenjtë, duke parë tani jetën në atë fytyrë të vogël si një alegori. Ditët dhe vitet do të kalonin, dhe mrekullia do të rritej e do të bëhej burrë.

- Eja të hash tani, - i tha Ingeri...

Isaku pret pemë dhe stivon drurin. Puna e tij përparon më mirë tani se më parë, meqenëse ka një sharrë. Sharron, krijon grumbuj; ai bën një rrugë me to, një qytet të ndërtuar me pirqje druri. Ingeri qëndron më shumë në shtëpi tani, dhe nuk del si më parë për ta parë atë në punë e sipër; Isaku duhet të gjejë një pretekst tani për të shkuar në shtëpi për një moment. Sa e çuditshme foshnja në kuti! Askush nuk mund t'i rezistojë britmave të saj, aq më tepër një burrë.

- Mos e prek! - i tha Ingeri. - I ke duart plot rrëshirë!

- Me rrëshirë, vërtet! Nuk je në vete! Nuk kam pasur rrëshirë në duart e mia qëkur ndërtova këtë shtëpi. Më jep djalin, më lër ta marr, do ta nanuris!

- Jo! Ja e sheh pushoi!

Në fillim të majit u erdhi një vizitore. Një grua erdhi midis kodrave në atë vend të vetmuar, ku askush nuk vinte kurrë; ajo ishte e afërmja e Ingerit, megjithëse e largët, dhe ata e mirëpritën atë siç duhej.

- Mendova të kaloja të shikoja se si është Briarta qëkur ajo na la.

Ingeri shikon fëmijën dhe i thotë me një zë pak keqardhës:

- Ah, askush nuk pyet se si je ti, sepse je ende i vogël.

- E shoh nga çehrja që ka! Je djalë i shëndetshëm. Dhe kush do ta kishte menduar një vit më parë, Ingeri, se do të të gjeja këtu me shtëpi, me burrë e fëmijë dhe gjithë këto gjëra.

- Nuk dua të mburrem, por ai më pranoi siç jam.

- Jeni martuar?... Ende pa martuar, me sa shoh.

- Do merremi edhe me këtë, duhet që ky njeriu i vogël të pagëzohet, - i thotë Ingeri. - Ne do të ishim martuar më parë, por nuk gjenim kohën. Si mendon ti Isak?

- Martesa? - thotë Isaku. - Po, natyrisht.

- Por sikur të na ndihmohet, Oline, - i thotë Ingeri. - Vetëm për t'ua kujdesur gjatë sezonit të ashpër për kafshët ndërsa ne jemi larg?

- Patjetër, - premtoi kushërira.

- Ne do të paguajmë për këtë.

Për këtë, ajo do t'ua linte atyre në dorë...

- Me sa shoh po ndërtoni përsëri. Tani çfarë do të jetë? A nuk keni ndërtuar mjaftueshëm?

- Pyete vetë se unë nuk di gjë.

- Çfarë po ndërtoj, oh, asgjë me rëndësi. Ndoshta një hangar të vogël, nëse do të na duhej - tha Isaku.

- Po Briartën dëshiron ta shohësh?

Shkuan në stallë për të parë lopën dhe viçen e saj. E për më tepër kishte edhe një dem. Kushërira vështronte me adhurim kafshët dhe stallën; gjithçka mirë siç mund të ishte, dhe e pastër siç mund të ishte e pastër.

- Ingeri është duarartë për kafshët, - thotë Oline.

- Briarta ishte e jotja më parë? - pyeti Isaku.

- Qëkur ishte një viç. Megjithatë, imja jo, por e djalit tim.

Por kjo është njësoj. Kemi ende nënën e saj.

Isaku nuk kishte dëgjuar një lajm më të mirë për një kohë të gjatë; ndihej i çliruar nga një peshë e rëndë. Briarta domethënë u përkiste atyre tashmë. Për të thënë të vërtetën, ai kishte menduar si të shpëtonte nga telashet; atë vjeshtë kishte menduar të therte lopën, të kruante lëkurën e të varroste brirët dhe kështu të gjitha gjurmët e lopës Briartë do të ishin zhdukur përgjithmonë. Por tashmë nuk kishte nevojë për këtë. Ai ndihej krenar për Ingerin!

- Eh, Ingeri, - thotë ai, - është e vetmja për të menaxhuar gjërat. E pastër dhe punëtore! Oh, nuk ka dy si ajo! Tek unë gjerat shkonin si shkonin sa gjeta një fermere.

- Është e natyrshme, - i tha Oline.

Ja kështu, ishte kjo grua nga kodrat, një krijesë me fjalë të buta dhe të mençura, dhe me emrin Oline, e cila qëndroi me ta disa ditë, dhe i lanë dhomën e vogël për të fjetur. Kur ajo u nis për në shtëpi, Ingeri i dhuroi një tufë leshi, nga delet. Nuk kishte asgjë për ta fshehur atë tufë leshi, por Oline u kujdes që Isaku të mos e shihte.

Fëmija, Isaku dhe gruaja e tij! Jeta vazhdonte përsëri, e njëjta botë me punët e ditës. Gëzime të vogla dhe ndonjëherë të mëdha. Briarta jepte qumësht me bollëk, dhitë kishin pjellë gjithashtu dhe prodhonin mirë qumësht. Ingeri kishte një radhë djathërash të kuq dhe të bardhë tashmë, të sistemuar për t'u vjetërsuar. Plani i saj ishte të kursente nga shitja e djathërave derisa të kishte mjaft për të blerë një tezgjah. Oh, pa shiko, Ingerin; ajo dinte të endte.

Isaku ndërtonte hangarin - ai gjithashtu kishte një plan të vetin, pa dyshim. Ai ngriti një krah të ri nga faqja e kasolles, me dyfishin e dërrasave, me një hyrje dhe një dritare të vogël; me një çati dërrasash që kishin ende lëvoren. Pastaj priti derisa të shkrihej toka dhe të mund të merrte baltë. Gjithçka që ishte e dobishme dhe e nevojshme; pa dysheme, pa mure të planifikuara mirë, por Isaku kishte ngritur një ndarje kuti, si për një kalë dhe një trinë.

Ishte afër fundit të majit. Dielli e kishte shkrirë tokën e kodrave; Isaku vuri në çati suvanë prej balte dhe mbaroi përfundimisht punën.

Atëherë një mëngjes hëngri një vakt për të zgjatur gjithë ditën, mori me vete edhe ca ushqim, mori kazmën dhe lopatën e zbriti në fshat.

- Më sill tre metra cohë pambuk, nëse mundesh, - thirri Ingeri pas tij.

- Për çfarë e do atë? - i tha Isaku.

Isaku ishte larg; pothuajse dukej sikur të kishte marrë rrugën për gjithmonë. Ingeri shikonte qiellin dhe drejtimin e erës, sikur të ishte duke pritur një anije me vela; ajo dilte natën për të dëgjuar; madje mendoi ta merrte fëmijën në krah dhe të shkonte pas tij. Më në fund ai u kthye, me një kalë dhe një karrocë.

- Hej, - bërtiti Isaku kur arriti para portës. Kali u soll mirë dhe qëndroi i qetë, duke nuhatur kasollen sikur ta njihte atë. Sidoqoftë, Isakut iu desh të thërrasë:

- Eja dhe mbaje pak kalin!

Ingeri doli.

- Oh, Isak, e ke marrë hua përsëri? Ku ke qenë gjithë këtë kohë? Kanë kaluar gjashtë ditë.

- Ku mendon se isha? Duhej të gjeja një rrugë për karrocën time. Mbama pak kalin tani.

- Karroca jote? Nuk ke ndër mend të më thuash që e ke blerë atë karrocë?

Isaku qëndroi i heshtur; Isaku ishte i ënjtur nga heshtja. Ai hoqi një parmendë dhe një lesë që kishte sjellë; gozhdë, ushqime, një gur mulliri, një thes me drithë.

- Si është fëmija? - pyeti.

- Fëmija është në rregull. Po më thuaj, a e ke blerë atë karrocë, sepse kjo është ajo që unë dua të di? Sepse kam

dëshirë pa masë të blej një tezgjah, - i thotë ajo duke bërë shaka, e mbushur me gëzim që e shihte përsëri.

Isaku u mbyll në vetvete edhe një herë, për një kohë të gjatë. Ishte i zënë me punët e veta, duke menduar e duke kërkuar rrotull për një vend për të vënë të gjitha ato gjëra që kishte sjellë; ishte e vështirë të gjeje vend në fermë. Por kur Ingeri hoqi dorë nga pyetjet dhe filloi të fliste me kalin, ai, më në fund, doli nga heshtja e tij dhe tha:

- Ke parë ndonjë fermë pa një kalë dhe qerre, pa lërues? Dhe meqë do ta dish, i kam blerë edhe kalin dhe karrocën, dhe gjithçka që është në të.

Dhe Ingeri vetëm mundi të tundte kokën dhe murmuriti:

- E po, unë kurrë nuk kam parë një njeri të tillë!

Isaku nuk ndihej më i përlulur; ai kishte paguar, si një zotëri, për Briartën.

- Tani jemi baras, nga ana ime solla një kalë.

Ndihej i lehtësuar, kundër zakonisht të tij; e zhvendosi lerën edhe një herë, e kapi dhe e mbarti me një dorë dhe e vendosi kundër murit. Oh, gjithë kjo pasuri! Ai mori gjërat e tjera: gurin, një pirun të ri që kishte blerë, të gjitha pajisjet e shtrenjta bujqësore, thesaret e shtëpisë së re, një koleksion madhështor. Tashmë i kishte të gjitha pajisjet e duhura - asgjë nuk mungonte.

- Hëm. Sa për tezgjahun, do ta gjejmë edhe atë, por më lër të marr pak frymë. Ja dhe coha e pambukut; ata nuk kishin asgjë tjetër përveç ngjyrës blu, kështu që unë e mora atë.

Nuk u gjendej fundi gjërave që solli. Një pus pa fund, i pasur me të gjitha llojet e gjërave, si një dyqan qyteti.

Ingeri shtoi:

- Sa do të doja që Oline t'i kishte parë të gjitha këto kur ishte këtu.

Mendje grash! Vanitet i pakuptimtë - sikur kjo të kishte rëndësi! Isaku shfryu me përbuzje. Megjithëse ndoshta ai vetë nuk do të ishte kënaqur nëse Oline do të kishte qenë atje për ta parë.

Fëmija po qante.

- Shko brenda dhe kujdesu për djalin, - i tha Isaku. - Ndërkohë po çoj kalin në stallë.

Ai zgjidhi kalin nga karroca dhe e çoi në stallë: e ushqeu, e goditi me përkëdhelje dhe e trajtoi me butësi. Dhe sa kishte borxh tani, për atë kalë dhe karrocën? Shumën e tërë, një borxh i fuqishëm; të gjitha duhet të shlyheshin atë verë. Do ta shlyente me dru për zjarr, lëvore dhe trarë për ndërtim. Kishte mjaft kohë përpara tij.

Por më vonë, kur krenaria dhe lavdia do të zbeheshin, kishte orë të hidhura frike dhe ankthi; të gjitha vareshin nga vera, nga vjeshta. Si do të ishin stinët?

Ditët tani ishin të zëna me punë në arë, gjithmonë puna në arë; ai hapi parcela të reja toke, duke nxjerrë rrënjë dhe gurë; lëroi, plehëroi, me lopatë dhe kazmë thyente gunga dheu dhe i thërrmonte me dorë dhe thembra. Isaku sistemonte tokën dhe e shtronte si qilima prej kadifeje.

Ai priti nja dy ditë më gjatë - derisa pati një vërshim shiu - dhe më pas mbolli grurin.

Për breza të tërë, që nga kohë të harruara, etërit e tij, para tij kishin mbjellë grurë. Ishte një mbrëmje e qetë, e ngrohtë, e mjegulluar nga një shi i butë, menjëherë pas fluturimit të patave gri.

Patatet ishin një gjë e re, asgjë mistike, asgjë fetare; gratë dhe fëmijët mund t'i mbjellin këto bimë që vinin nga larg ashtu si edhe kafja; ushqim i pasur, por shumë i ngjashëm me rrepën. Ndërsa gruri ishte buka; me grurë apo pa grurë do të thoshte jetë ose vdekje.

Isaku mbillte në emër të Krishtit. I ngurtë, si një trung peme me duar, por në zemrën e tij ishte si një fëmijë. Gjestet e tij ishin të ekzekutuara me kujdes, me një frymë plot mirësi e përukje.

Shikoni kokrrat e vockla që duhet të marrin jetë dhe do të rriten, shumohen; kështu bëjnë ato në të gjithë tokën ku mbjellësi i hedh. Në Palestinë, Amerikë, si dhe në luginat e Norvegjisë mbjellësi është si Isaku, një pikë e vogël në mes të gjithë kësaj bote, një mbjellës.

Dora lëshonte farat në ajër; qielli ishte i mjegullt dhe i butë, një shi i imët vadiste tokën.

Ishte sezoni i dimrit tashmë, por Oline nuk po vinte.

Isaku nuk ishte më i zënë nga puna në fushë ndaj merrej me përgatitjen e mjeteve për sezonin e ardhshëm: kosën dhe krehrin për korrrjet, përgatiti dy kosha për farat; dy dërrasa të gjata për karrocën, si dhe disa të tjera të përshtatshme për të bërë një sajë për dimrin. Shumë gjëra të dobishme bëri. Edhe në raftë. Ai vendosi disa raftë brenda shtëpisë, një vend i shkëlqyeshëm për të mbajtur gjëra të ndryshme, si një almanak, të cilin e kishte blerë para pak kohësh, garuzhdat dhe enë të tjera. Ingeri ishte e mrekulluar nga dy raftet.

Ajo kënaqej kollaj dhe ishte gjithmonë e lumtur me punën e tij!

Për Briartën, tani nuk kishin frikë se mos ikte, sepse kishte viçin dhe demin për të luajtur; ajo vraponte e lirë në pyll gjithë ditën. Edhe dhitë ishin të begata, gjinjtë e tyre të rëndë pothuajse zvarriteshin në tokë.

Ingeri bëri një fustan të gjatë me cohën prej pambuk blu, një pelerinë të vogël dhe një kapuç. Djali e ndiqte me sy kudo që ajo shkonte. Ishte një foshnjë e mrekullueshme dhe meqë e ëma kishte dëshirë t'i vinte emrin Eleseus, edhe Isaku nuk kishte ndonjë kundërshtim.

- Po ato rruazat e tua? - tha Isaku. - Nëse do t'i vësh ndonjëherë, tani është koha e duhur.

Oh, por Ingeri kishte menduar për to tashmë, për ato rruazat e saj. Nuk ishte kot nënë. Ingeri nuk tha asgjë dhe ishte shumë krenare. Rruazat nuk ishin të mjaftueshme për të bërë një gjerdan për djalin, por do të dukeshin bukur të qepura në pjesën e përparme të kapuçit të tij, e do të dukeshin bukur.

Por Oline nuk erdhi.

Nëse nuk do të kishte qenë për bagëtinë, ata mund të kishin shkuar të gjithë në fshat dhe të ktheheshin me fëmijën e pagëzuar siç e kërkonte zakoni. Dhe nëse nuk do të kishte qenë për çështjen e martesës, Ingeri mund të kishte shkuar vetë.

- Mund të shtyjmë martesën, propozoi Isaku.

Por Ingeri iu përgjigj:

- Duhet të presim dhjetë ose dymbëdhjetë vjet para se Eleseusi të jetë në gjendje të merret me fermën dhe bagëtinë vetë.

Isaku duhet të vriste mendjen për të gjetur një rrugëdalje. E gjithë gjëja kishte ardhur në një farë mënyre pa e llogaritur dhe martesja ishte po aq e rëndësishme sa edhe pagëzimi. Si t'ia bënin që t'i ndanin gjërat?

Thatësira mbretëronte - një thatësisë e ligë; nëse shiu do të vononte të vinte, të lashtat e tyre do të digjeshin. Por gjithçka ishte në dorën e Perëndisë. Isaku u bë gati të zbriste në fshat dhe të gjente dikë. Gjithë ato milje përsëri!

Më në fund, Oline erdhi...

Dhe ja tashmë ata janë të martuar dhe të pagëzuar, gjithçka sipas rregullave; ata i kishin këshilluar që së pari të bënin kurorëzimin, kështu që fëmija mund të pagëzohej si një fëmijë i ligjshëm. Por thatësira vazhdoi dhe dogji grurin e sapoçelur, dogji ata qilima të kadifenjtë - por pse? Gjithçka ishte në duart e Perëndisë. Isaku kositi livadhet afër dhe larg; kishte pak bar mbi to edhe pse toka ishte plehëruar në pranverë. Ai kositi në kodra, më larg dhe më larg; kositi dhe punoi tokën kudo, sepse ai kishte tashmë një kalë për të ushqyer dhe bagëtinë e tij. Në mes të korrikut ai vendosi të kosiste grurin, për foragjere; nuk kishte asnjë zgjidhje tjetër. Dhe tani të gjitha vareshin nga të korrat e patateve.

E çfarë mund të bënte me patatat? Vetëm pak gjëra si me kafënë; një luks, një ekstra? Oh, patatja, patatja është një bimë e pashoqe; thatësirë apo lagështi, ajo rritet dhe lulëzon njësoj. I bën ballë tekave të kohës dhe atë pak përkujdesje që i jep njeriu ia shpërblen pesëmbëdhjetë fish. Jo, nuk ka gjakun e rrushit, por ka mishin e një gështenje; e pjek në hi, ose e zien me ujë, ose e skuq. Një njeri mund të mos ketë misër për të bërë bukë, por jepi patate dhe ai nuk do të ketë uri. Nuk është e nevojshme të shtosh shumë për të bërë një gjellë; i zien në ujë, pak peshk të tharë, qumësht dhe mëngjesi është gati. Të pasurit i hanë me gjalpë; populli i varfër mjaftohet me një majë luge të vogël kripë. Isaku mund të bënte një gosti të dielave, me një pjatë krem nga qumështi i Briartës. Patatja, e përbuzur dhe e bekuar njëkohësisht!

Por tani gjërat dukeshin se po shkonin keq edhe për patatet.

Isaku shikonte vazhdimisht qiellin gjatë ditës. Dhe qielli ishte gjithmonë blu. Shumë mbrëmje me radhë dukej sikur do të binte shi. Isaku do të hynte brenda dhe do të thoshte:

“Jam i sigurt që do të bjerë shi”.

Dhe disa orë më vonë, të gjitha shpresat do të zbeheshin.

Thatësira kishte zgjatur shtatë javë dhe nxehtësia ishte e padurueshme; patatet lulëzonin gjatë gjithë kohës; lulëzonin mrekullisht, në mënyrë të panatyrshme. Fushat e grurit dukeshin nga larg sikur dremisnin nën dëborë. Kur do të mbaronte e gjithë kjo? Almanaku nuk jepte asnjë parashikim. Almanakët nuk janë më siç duhej të ishin; nuk shërbejnë më për asgjë. Tani dukej përsëri si për shi, dhe Isaku hyri dhe i tha Ingerit:

- Do të kemi shi këtë natë, nëse do Perëndia.

- Thua?

- Po, dhe nesër kali do të rrëshqasë mbi baltën e njomur të pyllit.

Ingeri vështroi në drejtim të derës dhe tha:

- Le të shohim atëherë.

Ranë disa pika. Orët kaluan, ata kishin ngrënë darkën e tyre dhe kur Isaku doli natën për të parë, qielli ishte blu.

- E po, mirë, - tha Ingeri, - sidoqoftë, këto pika shiu nuk e prishin likenin, deri nesër do ketë kohë për t’u tharë, - vazhdoi ajo për ta ngushëlluar si të mundte.

Isaku kishte mbledhur sasi të bollshme likeni. Ishte foragjere e mirë, dhe ai e trajtonte si të tillë, duke e mbuluar me lëvore në pyll. Kishte mbetur vetëm pak, dhe tani, kur

Ingeri foli për këtë, ai u përgjigj me dëshpërim, sikur të mos kishte rendësi:

- Nuk do ta mbuloj nëse koha është e thatë.

- Isak, nuk e ke seriozisht! - tha Ingeri.

Dhe të nesërmen, Isaku, nuk e futi brenda. Ai e la jashtë dhe nuk e preku, ashtu siç kishte thënë. Le të qëndronte aty ku ishte, gjithsesi nuk do të kishte shi; le të qëndronte aty ku ishte, në emrin e Zotit ai nuk do ta prekte!

Isaku ndihej i fyer thellësisht dhe tërësisht. Nuk kishte më kënaqësi të ulej jashtë në pragun e derës dhe të shikonte nga toka e tij, të ndihej zot i tyre.

Fusha e patateve lulëzonte çmendurisht dhe thahej; likeni qëndronte aty ku ishte - kushedi se ç'ndodhte? Ai, Isaku! Kush mund të thoshte; mbase ai kishte një mendim të vogël në kokë me gjithë thjeshtësinë e tij të ngurtë; mbase e dinte se çfarë bënte, në fund të fundit, duke provuar të tundonte qiellin blu për hënën e re.

Atë mbrëmje ai e pyeti sërish motin.

- Duhet të mbulosh likenin, - i tha Ingeri.

- Për çfarë? - tha Isaku, duke e parë me kureshtje.

- Ah, po tallesh! Mund të bjerë shi.

- Nuk do të ketë shi këtë vit, mund ta shohësh dhe vetë.

Por atë natë, qielli, që mund të shihnin përmes dritares së xhamtë, ishte më i errët - dhe diçka sikur filloi rrihte kundër xhamave, diçka e lagur, çfarëdo që të ishte. Ingeri u zgjua.

- Shiu! Shiko dritaren.

Por Isaku vetëm nuhati.

- Shiu? Jo aspak. Nuk e di se për çfarë po flet.

- E ke gabim që tallesh! - i tha Ingeri.

Shi ishte, sigurisht, dhe një dush i mirë e i rëndë - por zgjati aq sa për të lagur likenin e Isakut, dhe u ndal. Qielli ishte blu përsëri.

- E sheh që doli fjala ime, - tha Isaku, me mllef.

Shiu nuk iu solli asnjë ndryshim patateve, dhe ditët erdhën e shkuan; qielli ishte blu.

Isaku u përpoq të ndërtonte parmendën e tij prej druri, u përpoq shumë duke punuar e zdrukthuar me përlësi. Eh, Perëndi! Ditët erdhën dhe shkuan e fëmija u rrit. Ingeri rrihte gjalpin dhe bënte djathë; nuk kishte ndonjë rrezik serioz; fermerët e fortë në tokat e tyre janë në gjendje t'i mbijetojnë një viti të keq. Për më tepër, pas nëntë javësh, erdhi një bekim, shi i rregullt, shi gjatë ditës e natës, gjashtëmbëdhjetë orë pa pushim. Nëse do të kishte ardhur dy javë përpara, Isaku do të thoshte:

“Tepër vonë!”.

Por tani ai i tha Ingerit:

- Do e shohësh, do të shpëtojmë disa nga patatet.

- Po, - tha Ingeri me shpresë. - Të gjitha madje, do e shohësh.

Gjërat sikur po merrnin për më mirë. Shi çdo ditë; dushe të mira, të plota. Gjithçka dukej përsëri e gjelbër, si për mrekulli. Patatet lulëzonin akoma, disa fruta të mëdha rriteshin në majat, gjë që nuk ishte normale; por askush nuk mund të thoshte se çfarë mund të kishte poshtë në rrënjë - Isaku nuk kishte guxuar të shikonte. Pastaj një ditë Ingeri doli jashtë dhe gjeti një mori patatesh të vogla nën një bimë.

- Duhet edhe pesë javë për t'u rritur, - tha Ingeri.

Ingeri provonte gjithmonë të ngushëllonte dhe të fliste me shpresë përmes buzëlepurit të saj. Nuk ishte e këndshme

ta dëgjoje kur ajo fliste, kishte si një fishkëllimë, si avulli që del nga një valvul, por ajo ishte mbështetëse në këtë vend të vetmuar, dhe një shpirt i lumtur dhe i gëzuar në çdo kohë.

- Sikur të na bëje një shtrat tjetër, - i tha ajo Isakut, një ditë.

- Joo!

- Nuk ka ngut, por...

Ata filluan të shkulin patatet, dhe përfunduan ditën e Shën Mihalit, sipas zakonit. Ishte një vit i ndërlikuar - por një vit i mirë; edhe një herë u pa që patatet nuk ndikoheshin kaq shumë nga moti, por rriteshin kudo duke u përshtatur.

Tani Isaku kishte disa javë më shumë për të punuar tokën para ngricës. Bagëtitë ishin jashtë, duke kullotur aty ku ua kishte ënda; ishte e këndshme për Isakun kur punonte, të dëgjonte këmborët e tyre, megjithëse disa herë e pengonin. Demi, kjo kafshë e djallëzuar, shkante të hante likenin. Sa për dhinë, ato ishin kudo lart e poshtë, madje edhe deri mbi çatinë e kasolles.

Probleme të mëdha dhe të vogla.

Një ditë Isaku dëgjoji një britmë të papritur; Ingeri qëndronte në pragun e derës me fëmijën në krahë, duke treguar demin dhe lopën e vogël Briargjendte që po bënin dashuri. Isaku rrëmbeu lopatën dhe shkoi me vrap, por ishte tepër vonë, e keqja ishte bërë.

- Oh, vogëlushja, ajo është shumë e re, ende një fëmijë!

Isaku e futi në stallë.

- E po, mirë, - tha Ingeri, - nuk ka asgjë ë keqe, në fund të fundit, në njëfarë mënyre; nëse ajo do të priste, ne do t'i kishim të dyja lopët e mbarsura në të njëjtën kohë.

Oh, kjo Ingeri; mund ta ketë ditur mirë se çfarë bënte kur lejoi që Briargjenda dhe demi të rrinin së bashku atë mëngjes.

Erdhi dimri, Ingeri turrte e thurte. Isaku vazhdonte të zbriste stiva me dru; dru i thatë dhe i mirë; të gjitha borxhet e tij ishin shlyer me kohë; kali dhe qerrja, veglat, të gjitha ishin të tijat tashmë. Ai zbriti me djathërat e qumështit të dhive të Ingerit dhe solli përsëri fije leshi, një tezgjah dhe gjithçka që ishte e nevojshme; solli miell dhe ushqime, shumë dërrasa dhe gozhda; një ditë ai solli në shtëpi një llambë.

- Edhe pse e shoh me sytë e mi më duket e pabesueshme, - i tha Ingeri.

Por ajo kishte kohë që shpresonte për një llambë të tillë.

Ata e ndezën po atë mbrëmje dhe u ndjenë si të ishin në parajsë; Eleseusi i vogël mendoj, pa dyshim, se ishte dielli.

Tani Ingeri mund të qepte darkave me dritë.

Isaku bleu cohë për këmisha dhe këpucë të reja për Ingerin. Ajo kishte kërkuar disa ngjyra për leshin, dhe ai ia solli.

Pastaj një ditë u kthye me një orë.

- Po kjo çfarë është?

- Një orë.

Kjo ishte shumë për Ingerin; ajo ishte e befasuar dhe nuk mundi të thoshte asnjë fjalë. Isaku e vari në mur dhe e kurdisi duke e lenë pastaj të tingëllonte. Fëmija ktheu sytë nga tingulli dhe më pas shikoi nënën e tij.

- Po, ke pse të habitesh, - tha Ingeri dhe mori fëmijën në prehër.

Nga të gjitha gjërat e mira, që kishte sjellë Isaku, nuk kishte asnjë më të mirë se kjo, një orë për të përhapur tinguj gëzimi gjatë ditëve të gjata e të trishta të dimrit.

Isaku filloi të hapte terrenin e të priste pemë. Tani, kishte një hapësirë të gjerë të kodrës, e gjitha gati për mbjellje. Kur pa që kishte hapësirë mjaftueshëm ai preu vetëm pemët e thata.

Ai e dinte mjaft mirë, natyrisht, për çfarë duhej krevati. Kështu që iu vu punës me ngut.

Një mbrëmje të errët u kthye në shtëpi nga pylli, gjeti Ingerin të shtrirë dhe pranë saj një djalë tjetër. Eh Inger! Në mëngjes i kishte thënë se duhet të shkonte përsëri në fshat, me pretekstin se kali kishte nevojë të ecte. Isaku e kuptoi tani se ajo kishte dashur ta largonte nga shtëpia. Po pse?

- Pse nuk mund të ma thoshe?

- Shtro për vete në dhomën e vogël, - i tha Ingeri.

Isaku e kishte përgatitur një shtrat druri, por nuk kishte mbulesa. Çifti kishte vetëm një batanije lëkure dhe duhet të prisnin vjeshtën për të therur kafshët e tjera. Isaku kaloi net të vështira, për ca kohë; ai u përpoq të mbulohej me kashtë duke fjetur në stallë me lopët.

Veçse gjëra të mrekullueshme kishin arritur, atje në shkretëtirë; shtëpi për vete e strehim për bagëtinë dhe tokë të kultivuar, të gjitha në tre vjet. Isaku po ndërtonte përsëri - çfarë po ndërtonte tani? Një hangar të ri, si zgjatim i shtëpisë. I gjithë vendi tundej nga zhurma e gozhdimeve. Ingeri ankohej se zhurma linte të vegjlit pa gjumë.

Po a mund të mos bënte zhurme tek punonte? Kishin vënë të gjitha ushqimet në stallë për të mos i lënë jashtë; por

gjithçka merrte një erë dhe shije të keqe, kështu që hangari ishte kthyer në një nevojë urgjente. Ndërsa kalamajtë do të mësoheshin me zhurmën.

Eleseusi ishte shëndetlig, ndërsa tjetri ushqehet fuqishëm nga gjiri si një foshnjë e shëndetshme, dhe kur nuk qante flinte. Një fëmijë i pashoq! Isaku nuk bëri asnjë vërejtje për emrin kur Ingeri vendosi ta quante Sivert, megjithëse ai vetë do të preferonte Jakob. Por në raste të tilla ai i jepte të drejtë Ingerit. Ajo kishte zgjedhur emrin Eleseus pasi ishte emri i priftit të famullisë së saj; ndërsa Sivert, emri i xhaxhait të nënës së tij, arkëtari i thesarit të qarkut, i cili ishte një burrë i mirë, pa grua dhe as fëmijë për t'i lënë trashëgiminë e tij. Ata nuk mund të bënin më mirë sesa ta quanin djalin si ai.

Pastaj erdhi pranvera dhe puna e sezonit të ri; gjithçka duhej të mbaronte përpara Rrëshajave. Kur kishte vetëm Eleseusin për t'u kujdesur, Ingeri kurrë nuk mund të gjente kohë për të ndihmuar burrin e saj; tani, me dy fëmijë në shtëpi, ishte ndryshe; ajo ndihmonte në fusha dhe kryente punë të ndryshme aty-këtu; në mbjelljen e patateve, të karotave dhe të rrepave. Një grua si kjo nuk ishte aq e lehtë për t'u gjetur. Dhe thurte përveç të tjerave; sapo kishte pak kohë ajo vraponte në dhomën e vogël dhe endte çarçafë dhe veshje të brendshme për dimër. Ajo e ngjyente leshin dhe bënte veshje të kuqe dhe blu për veten dhe të vegjlit; më në fund, bëri një shtrojë për Isakun. Veçse gjëra të dobishme dhe të nevojshme, dilnin nga duart e saj.

Gjithçka po shkonte shkëlqyeshëm, për këta banorë të pyllit; dhe nëse këtë vit do të kishin të korra të mira ata do të lakmoheshin nga të tjerët. Çfarë u mungonte ende? Një

plevicë, ndoshta; një hambar i madh me një dysHEME ku mund të pastronin grurin - por të gjitha këto ishin gjëra që mund të vinin me kohë. Do të vinin, kjo ishte e sigurt.

Ja, Briargjenda kishte pjellë një viç, delet kishin bërë qengja, dhitë kishin bërë keca, ferma tashmë gumëzhinte nga të porsalindurit.

Po vetë familja e vogël? Eleseusi mund të ecte tashmë, të shëtiste kudo që të dëshironte, dhe Siverti i vogël ishte pagëzuar. Ingeri? Duke u bërë gati për një lindje tjetër. Një fëmijë tjetër - oh, kjo nuk ishte asgjë për Ingerin! Ajo ishte mjaft krenare për familjen e saj. I falej Zotit që e kishte bekuar me fëmijë kaq të shkëlqyeshëm. Ingeri kur ishte e vogël, kishte vuajtur nga ceni i saj: djemtë nuk ia hidhnin sytë dhe ajo nuk kishte mundësi as të kërcente e as të gjente punë. Por tani kishte ardhur koha e saj; ajo lulëzonte dhe kishte vazhdimisht fëmijë. Isaku, i zoti i shtëpisë, ishte hijerëndë dhe i ngurtë si kurrë më parë, por ai ia kishte dalë mbanë dhe ishte i lumtur. Si kishte arritur të jetonte para sa të vinte Ingeri, ky ishte një mister; ishte ushqyer me patate dhe qumështin e dhive, ose ndoshta ndonjëherë edhe me gjëra të çuditshme. Por tani, ai kishte gjithçka që një njeri, në vendin e tij, mund të mendonte.

Erdhi një thatësi tjetër, të korrrat ishin të këqija. Laponi Os-Anders, duke kaluar andej me qenin e tij, solli lajmin se në fshat kishin korrur grurin tashmë, për ushqim për bagëtinë.

- Të paktën kanë harenga me bollëk, sepse këtë vit peshkimi shkoi mirë. Xhaxhai yt Sivert, do të ndërtojë një shtëpi në fshat.

- Nuk ishte keq edhe ashtu.
- Kjo është e vërtetë, dhe të gjithë ju me sa duket.
- Shyqyr Zotit nuk kam pse të ankojem, çfarë thonë ata të shtëpisë për mua?

Os-Andersi tundi kokën lehtë; nuk gjente fjalët për të treguar.

- Nëse ke dëshirë të pish një tas qumësht, mjafton të më thuash, - i tha Ingeri.

- Mos u lodh për mua, por nëse ke diçka për qenin...

Qumësht për Os-Andersin, dhe ushqim për qenin. Os-Andersi ngriti kokën papritmas, sepse dëgjoi një lloj muzike nga brenda shtëpisë.

- Çfarë është kjo muzikë?

- Oh, sahati. Tregon orët në këtë mënyrë, - iu përgjigj Ingeri duke shpërthyer nga krenaria.

Laponi tundi kokën përsëri:

- Shtëpi, kalë, bagëti dhe gjithfarëlloj gjërash. Nuk ka asgjë për të cilën mund ta mendojë një njeri, e që ti nuk e ke.

- I jemi shumë mirënjohës Perëndisë për këtë, kjo është e vërtetë.

- Kam harruar të them, Oline më pyeti për ty.

- Oline? Si është?

- Shumë mirë është. Ku e ke burrin?

- Në punë, diku nëpër fusha.

- Thonë se ai nuk ka paguar akoma, - tha laponi pa kujdes.

- Të paguajë? Për çfarë? Kush thotë kështu?

- Kjo është çfarë thonë.

- Por kush është ai që pagan një tokë pa zot.

- Ke të drejtë.

- Dhe gjithçka përreth është bërë me djersën e ballit.

- Por, ata thonë se shteti zotëron të gjithë tokat përreth.

Ingeri nuk kuptonte asgjë nga këto çështje.

- Mbase ashtu është. E kush pretendon një gjë të tillë, mos vallë Oline?

- Nuk mbaj mend mirë, - ia ktheu laponi dhe shikimi i tij lëvizte kudo përreth.

Ingeri ishte e habitur sesi ai nuk kishte lypur ende gjë; Os-Andersi gjithmonë lypte, ashtu si të gjithë laponët. Os-Andersi zuri vend, ngjeshi pipën dhe e ndezi. E ç'pipë! Ai e thithte aq fort sa fytyra e tij e vjetër, e rrudhur dukej si një pergamenë runik¹.

- Nuk ka nevojë të pyes nëse të vegjlit janë të tutë, - shtoi ai, duke e përgëzuar përsëri. - Ata janë si ti kur ishte e vogël.

Kjo ishte një gënjeshtër, Ingeri ishte një përbindësh; por gjithsesi ajo ndjeu krenari për të gjitha këto.

- Nëse nuk do ta kishe të mbushur deri në grykë çantën, do të gjeja diçka që ta merrje me vete, - i tha Ingeri.

- Jo, nuk ke pse të vihesh në siklet.

Inger hyri brenda me fëmijën në krah; Eleseusi qëndroi jashtë me plakun. Të dy bënë miqësi menjëherë; fëmija pa diçka në thes që i tërhoqi vëmendjen, diçka të butë me gëzof, dhe donte ta përkëdhelte. Qeni qëndronte vigjilent

¹ Alfabet i përdorur për të shkruar gjuhët gjermanike nga popujt që i flisnin këto gjuhë, si skandinavët, frisiansët, anglo-saksonët etj. (shën. i përkth.).

dhe lehu. Ingeri doli me një pako me ushqime; ajo lëshoi një britmë dhe u ul në pragun e derës.

- Çfarë ke atje? Çfarë është?

- Asgjë. Vetëm një lepur.

- E pashë.

- Djali donte ta shihte. Qeni e kapi sot në mëngjes...

- Ja ku është ushqimi yt për drekë, - tha Ingeri.

5

Një vit i keq nuk vjen kurrë vetëm, thuhet në bazë të eksperiencave të vjetra. Isaku ishte rritur me konceptin e durimit dhe tashmë ishte në pritje të fatit të tij. Gruri digjej, bari ishte i shkretë, por patatet dukeshin sikur po rezistonin edhe këtë herë. Sa keq ishin të gjitha gjërat e mbledhura së bashku, por mund të ishin edhe më keq. Isaku kishte akoma dru zjarri për të shitur në fshat, dhe, meqenëse peshkimi kishte qenë i begatë, njerëzit kishin pará për të blerë dru. Në të vërtetë, dukej pothuajse si një providencë, që korrja e grurit kishte dështuar: sepse ku do ta kishte magazinuar atë pa një hambar? Ta quash këtë providencë, ndonjëherë, nuk i bën dëm askujt.

Isaku kishte gjëra të tjera për t'u marrë. Kush ishte ky lapon që i kishte thënë Ingerit atë verë “thonë se nuk ka paguar”? Për çfarë duhet të paguante? Toka ishte aty, pylli ishte aty; ai e kishte pastruar dhe përgatitur, kishte ndërtuar një shtëpi në mes të një shkretëtire natyrore, duke fituar bukën e gojës për vete dhe familjen e tij, duke mos kërkuar asgjë nga asnjë njeri, por duke punuar dhe duke u rropatur

vetëm. Ai shpesh e kishte menduar të pyeste lensmandin¹ për këtë çështje kur zbriste në fshat, por gjithmonë e kishte shtyrë për më vonë; lensmandi nuk ishte një njeri i këndshëm, sipas të thënave, dhe Isaku nuk ishte nga ata që të fliste shumë. Çfarë mund t'i thoshte nëse shkonte - për çfarë kishte vajtur?

Një ditë, atë dimër, vetë Geisleri erdhi i hipur në karrocë. Ishte i shoqëruar nga një burrë dhe një thes me letra. Ai vështroi kodrën e gjerë të hapur, të pastruar nga drurët e të niveluar nën dëborë; ai mendoi se ndoshta ishte e gjitha tokë e kultivuar tashmë, sepse tha:

- E gjitha kjo është një fermë e madhe. Nuk mendon t'i kesh të gjitha këto falas?

Isaku ishte i terrorizuar dhe nuk tha asnjë fjalë.

- Duhet të kishë ardhur tek unë në fillim, dhe të blije tokën, - tha Geisleri.

- Po.

Lensmandi foli për vlerësimet, për kufijtë, taksat, taksat për shtetin dhe, kur ai e shpjegoi pak çështjen, Isaku filloi të shihte se në të kishte diçka të arsyeshme. Lensmandi iu drejtua shoqëruesit të tij duke e pyetur:

- Atëherë, ti që e quan veten ekspert, cila është shtrirja e tokës së kultivuar këtu?

Por pa pritur që tjetri të përgjigjej, hamendësoi vetë një shifër.

¹ Sherifi, përgjegjësi i një rrethi të vogël.

Pastaj e pyeti Isakun për të korrat, për sanën e patatet. Dhe më pas në lidhje me kufijtë. Ata nuk mund të bënin xhiron e pronës kur gjithçka ishte e mbuluar nën dëborë. Çfarë mendonte vetë Isaku për shtrirjen e pyjeve dhe të kullotave?

Isaku as që nuk ia kishte idenë; ai e kishte menduar gjithnjë vendin si të tijin aq sa mund t'i shihte syri. Lensmandi tha që shteti kërkonte kufij të caktuar.

- Dhe sa më e madhe është shtrirja, aq më shumë do të duhet të paguash.

- Oh!

- Dhe nuk do të të japim gjithçka që mendon se mund të gëlltisësh; do të lejojmë të kesh atë që është e arsyeshme për nevojat e tua.

- Oh!

Ingeri solli qumësht për vizitorët; ata e pinë, dhe ajo u solli ca më shumë. Lensmandi një njeri hije rëndë? Ai përkëdheli flokët e Eleseusit dhe vështroi diçka me të cilën luante fëmija.

- Me ç'gurë është duke luajtur? Më lejoni t'i shoh. Janë të rëndë. Duket si një lloj minerali.

- Ka mjaft të tillë në kodra,- tha Isaku.

Lensmandi iu kthye çështjes së tyre.

- Në jug dhe perëndim do të kultivosh më shumë? Mendoj se po? A do të themi çerek milje në jug?

- Çerek milje! - bërtiti ndihmësi i tij.

- Nuk mund të kultivosh më shumë se dyqind metra, - tha menjëherë shefi i tij.

- Sa do të më kushtojë? - pyeti Isaku.

- Nuk mund të them. E gjitha varet. Por unë do ta vë çmimin sa më të ulët që mundem në raportin tim; këtu është milje larg nga kudo dhe është e vështirë për t'u arritur.

- Po, por një të tërë! - protestoi përsëri ndihmësi.

Lensmandi shkroi, dy krahë në jug, dhe pyeti:

- Po në lidhje me kodrat? Sa do?

- Do të më duhen të gjitha deri te lumi, - tha Isaku.

Lensmandi mbajti shënim. - Dhe sa larg në veri?

- Nga ajo anë nuk ka veçse dru të keq dhe kënetë, nuk ka vlerë.

Lensmandi fiksoi kufirin në veri në një gjysmë milje.

- Lindja?

- Asgjë me rëndësi edhe aty. Vetëm fushë e zhveshur nga këtu në Suedi.

Lensmandi shënoi përsëri. Ai bëri një llogaritje të shpejtë dhe tha:

- Do të jetë një terren me madhësi të mirë. Kudo afër fshatit, natyrisht, do të vlejë shumë pará; askush nuk mund ta kishte blerë atë. Duke llogaritur përmasat mund të them se njëqind dalerë do të ishte e drejtë.

- Si mendon? - pyeti ndihmësin e tij.

- Po e jep për hiçgjë, - tha tjetri.

- Njëqind dalerë? - tha Ingeri.

- Isak, mos merr një terren kaq të madh.

- Jo, - tha Isaku.

Ndihmësi shtroi me nxitim:

- Kjo është ajo që thashë. Është shumë, çfarë do të bësh me gjithë këtë?

- Do ta kultivojë, - thirri lensmandi.

Ai kishte llogaritur e shkruar gjithçka, ndërkohë që fëmijët qanin përreth tij; nuk donte të bënte çdo gjë nga e para. Rruga ishte e gjatë, do t'i duhej të kthehej vonë atë natë në shtëpi, mbase jo para mëngjesit. Futi letrat në çantë.

- Lidhe kalin në karrocë, - i tha shoqëruesit të tij. Dhe duke iu drejtuar Isakut:

- Në të vërtetë, ata duhet të ta japin terrenin dhe të të paguajnë, për punën që ke bërë. Do të them më shumë kur të dërgoj raportin. Pastaj do të shohim se sa do të kërkojë shteti për terrenin.

Isaku - e vështirë të thuash sesi ndihej - ishte disi i lumtur, në fund të fundit, që toka e tij vlerësohej me një çmim të madh, pas punës që ai kishte bërë. Sa për njëqind dalerët, ai mund të arrinte t'i paguante, pa dyshim, me kalimin e kohës.

Ingeri falënderoi lensmandin dhe shpresoi që ai të thoshte një fjalë të mirë për ta në shtet.

- Po, po. Por unë nuk jam i vetmi që kam zë në këtë çështje. Çka mund e duhet të bëj është të them atë që kam parë dhe atë që mendoj. Sa vjeç është më i vogli?

- Gjashtë muaj.

- Djalë apo vajze?

- Djalë.

Lensmandi nuk ishte zemërkeq dhe tregohej dashamirës me kolonët. Ai e injoroi ndihmësin e tij, Brede Olsenin, i cili për shkak të detyrës së tij duhet të ishte eksperti në çështje të tilla. Megjithatë për Isakun dhe gruan e tij ishte çështje mjaft serioze.

Lensmandi papritmas pyeti:

- Si quhet ferma?

- Si quhet?

- Po. Si quhet? Na duhet të kemi një emër për të.

Askush nuk e kishte menduar më parë këtë. Ingeri dhe Isaku panë njëri-tjetrin.

- Selanra? - tha lensmandi. Ai duhet ta kishte shpikur atë; mbase nuk ishte fare emër.

Por ai përsëriti:

- Selanra!

U largua më një përshëndetje me kokë.

Disa javë më vonë, kur Isaku shkoi në fshat, ai dëgjoi fjalë për disa punë në lidhje me lensmand Geislerin; me sa thuhej kishte pasur një hetim në lidhje me disa shuma mbi të cilat ai nuk mund të jepte llogari, dhe çështja ishte raportuar tek eprori i tij.

Një ditë pasi Isaku zbriti me një ngarkesë druri dhe po kthehej, nga pylli doli lensmand Geisleri. Ai doli nga pemët, në rrugë, tundi dorën dhe thjesht tha:

- Më merr dot dhe mua?

Ata ecën për një kohë, pa folur. Pasi pasagjeri mori një shishe nga xhepi dhe piu disa gllënjka; ia ofroi Isakut, i cili nuk pranoi.

- Kam frikë se ky udhëtim do të shqetësojë stomakun tim, - tha lensmandi.

Ai filloi menjëherë të fliste për çështjen e Isakut në lidhje me tokën.

- Unë e dërgova raportin menjëherë, me një rekomandim të fortë. Selanra është një emër i bukur. Në fakt, ata duhet të ta japin falas, por shteti ka çmimet e tij. Unë sugjerova pesëdhjetë dalerë.

- Oh. Pesëdhjetë, thatë? Jo njëqind?

Lensmandi rrudhi ballin dhe u mendua një moment.

- Me sa kujtoj ishte pesëdhjetë. Po...

- Për ku jeni nisur kështu? - pyeti Isaku.

- Te njerëzit e sime shoqeje, në Vesterboten.

- Është e vështirë të kalosh nga ato anë në këtë periudhë të vitit.

- Do ia dal. Mund të më shoqërosh ti një copë rrugë?

- Sigurisht që po, nuk të lë vetëm nëpër acar.

Ata mbërritën në fermë dhe lensmandi qëndroi një natë dhe fjeti në dhomën e vogël. Në mëngjes, ai nxori përsëri shishen e tij dhe tha:

- Jam i sigurt që ky udhëtim do të më shqetësojë stomakun.

Për pjesën tjetër, ai ishte shumë i ngjashëm me herën e kaluar, me dashamirësi, vendosmëri, por i mërëzitur dhe i shqetësuar pak për punët e tij. Ndoshta nuk do të jetë aq keq, në fund të fundit.

Isaku guxoi t'i tregonte se maja e kodrës nuk ishte ende e gjitha në kultivim, por vetëm disa parcela të vogla tek-tuk. Lensmandi e mori informacionin dhe i dha një përgjigje të çuditshme.

- E dija mjaft mirë, natyrisht, që nga hera e fundit që isha këtu, kur bëra raportin. Por Brede, ndihmësi im, bëri sipas mendjes së tij. Departamenti e përpunon informacionin përmes tabelave. Me gjithë sipërfaqen që deklarova dhe rendimentin e pakët që jep në foragjere e patate, ata do të thonë menjëherë se duhet të jetë toka e dobët, tokë e lirë, e kuptoni. Unë bëra çmos për ju, dhe ju jap fjalën për këtë!

Duhen nja dy a tridhjetë mijë burra si ti që të ngrihet ky vend.

Lensmandi u kthye nga Ingeri.

- Sa vjeç është më i vogli?

- Nëntë muajsh tani.

- Dhe është djalë?

- Po.

- Por duhet ta ndiqni dhe ta rregulloni këtë çështje sa më shpejt që të jetë e mundur, - i tha ai përsëri Isakut.

- Është dhe një njeri tjetër që dëshiron të blejë tani tokën mes fermës dhe fshatit, dhe sa më shpejt ta bësh, aq më shumë do të ngrihet vlera. Blije tani, merr tokën i pari dhe le të rritet çmimi më pas, në këtë mënyrë do të marrësh një shpërblim për të gjithë punën që ke bërë. Ishe ti që fillove të kultivosh këtu, gjithë këtë shkretëtirë.

Ata i ishin mirënjohës për këshillat dhe e pyetën nëse nuk ishte ai vetë që do ta rregullonte çështjen. Ai u përgjigj se kishte bërë gjithçka që kishte në dorë; tani çdo gjë varej nga shteti.

- Unë jam duke shkuar për në Vesterboten tani, dhe nuk do të kthehem, - u tha ai drejtpërdrejt.

Ai i dha Ingerit një monedhë, dhe kjo ishte shumë.

- Mund të çosh pak mish te njerëzit e mi në fshat herën tjetër kur të therësh ndonjë kafshë, - tha ai. - Gruaja ime do t'ju paguajë. Merrni një djathë apo dy, sa herë që të keni mundësi. Fëmijëve u pëlqen shumë.

Isaku u ngjiti me të kodrave; bora ishte e fortë, dhe e bënte rrëshqitjen të kollajtë me sajë. Isaku mori një daler të tërë.

Kështu e la vendin lensmand Geisleri dhe nuk u kthye më. Asnjë humbje e madhe, mund të thoshte populli, ai shihej si një personazh i dyshimtë, një aventurier. Jo se ai nuk kishte dije; ai ishte një njeri i ditur dhe kishte studiuar shumë, por jetonte me bollëk, dhe harxhonte paratë e njerëzve të tjerë. Doli më vonë se ai ishte larguar nga vendi pas një qortimi të fortë nga eprori i tij, Amtmand Pleim¹; por asgjë nuk u bë zyrtare në lidhje me familjen e tij. Gruaja dhe tre fëmijët e tij vazhduan të jetonin atje, një kohë të mirë pas largimit të tij. Dhe nuk vonoi shumë, paratë e shpërdoruara u dërguan nga Suedia, kështu që nuk mund të thuhej se gruaja dhe fëmijët e Geislerit mbaheshin peng, por qëndronin se ua kishte ënda.

Isaku dhe Ingeri nuk kishin arsye të ankoheshin për marrëdhëniet me Geislerin. Dhe një Zot e dinte se ç'illoj njeriu do të ishte pasardhësi i tij - mbase ai do ta hapte nga e para çështjen e fermës!

Amtmandi dërgoi në fshat një nga nëpunësit e tij, për të qenë lensmandi i ri. Ai ishte një burrë rreth të dyzetave, bir i një gjykatësi lokal, me emrin Heyerdahl. Nuk kishte pasur të ardhura të mjaftueshme për të shkuar në universitet dhe për të hyrë në shërbim si gjykatës; për këtë arsye, ai kishte qenë i detyruar të ulej në një zyrë, e të përmbushte shkresa, për pesëmbëdhjetë vjet me radhë. Ishte i pamartuar, pasi nuk kishte arritur kurrë të siguronte jetesën e një gruaje. Shefi i tij, Amtmand Pleimi, e kishte trashëguar atë nga

¹ Guvernatori i një vendi.

paraardhësi i tij dhe i jepte të njëjtën pagë të mjerueshme që i ishte dhënë më parë; Heyerdahl e pranoi dhe vazhdoi me shkresat administrative në tryezën e tij si më parë.

Isaku mori guximin dhe shkoi ta takonte.

- Dokumentet e çështjes Selanra?... Këtu janë, sapo janë kthyer nga departamenti. Ata duan të dinë shumë gjëra, e gjithë kjo punë është një mashtrim i tmerrshëm, pasi Geisleri e la atë, - tha zyrtari. - Departamenti dëshiron të informohet nëse ndonjë kulturë e konsiderueshme duhet të llogaritet në pasuri. Pavarësisht ndonjë lënde drusore, metaleve me vlerë në kodrat ngjitur apo burimeve të tjera. Ky Geisleri duket se ka siguruar informacione të caktuara, por ai nuk duhet të besohet, dhe ja ku duhet ta kaloj tërë çështjen përsëri pas tij. Do të duhet të dal e të vij në "Selanra" dhe të bëjmë një inspektim e vlerësim të plotë. Sidoqoftë, do të duhet të bëhet sa më shpejt. Departamenti nuk mund të presë gjatë gjithë verës për një përgjigje. Do të vij vetë sa më shpejt që të mundem, sa të çlirohem nga punët e zyrës. Do të duhet të vij në çdo rast, sepse ekziston një blerës tjetër i tokës që pret gjithashtu një përgjigje.

- A është ai që do të blejë midis meje dhe fshatit?

- Nuk mund të them, nuk jam i sigurt. Shumë e mundshme. Në fakt, është një njeri nga zyra këtu, ndihmësi im më saktësisht. Ai ishte këtu në kohën e Geislerit. E kishte pyetur Geislerin për këtë, por ai ia preu shkurt; i tha që nuk mund të kultivonte njëqind jardë tokë. Kështu që ai dërgoi një kërkesë te Amtmandi dhe unë jam i udhëzuar që ta shoh çështjen. Një prej shumë mashtrimeve të Geislerit!

Lensmandi Heyerdahl u ngjit në fermë dhe mori me vete ndihmësin e tij, Brede. Të dy funksionarët u zhytën në llucën e kënetës e në borën e shkrirë, u bënë qull derisa përfunduan përcaktimin e kufirit lart e poshtë kodrave. Lensmandi punoi me zell ditën e parë, por të dytën ai u mjaftua duke qëndruar në këmbë për pjesën më të madhe të kohës, duke treguar me gisht dhe duke dhënë udhëzime me zë të lartë.

Departamenti kërkonte informacione për një numër pikash - kishte tabela për të gjitha llojet e informacioneve, pa dyshim. E vetmja gjë që dukej e arsyeshme ishte çështja e drurit. Sigurisht, që kishte një lëndë drusore të rëndë, dhe kjo brenda kufijve të territorit të Isakut, por jo aq sa duhej, që të konsiderohej për një shitje të organizuar. Edhe sikur të kishte lëndë drusore me bollëk, kush do t'i bartte gjatë gjithë atyre miljeve deri në vendin ku mund të shitej? Vetëm Isaku, duke u lëkundur si një varkë nëpër pyll, në kohën e dimrit, duke tërhequr trarë të rëndë poshtë në fshat, për të sjellë përsëri dërrasa për ndërtesën e tij, mund ta bënte një gjë të tillë. Geisleri, me sa dukej, kishte ndryshuar mendje para se të dërgonte raportin. Tashmë pasardhësi i tij po i përsëriste të gjitha gjërat edhe një herë, duke u përpjekur të gjente gabime dhe pasaktësi, por gjithçka më kot. Ishte e dukshme që ai këshillohej me ndihmësin e tij në çdo hap dhe i kushtonte vëmendje fjalëve të tij, në të kundërt të Geislerit. Asistenti, për më tepër, duhet të kishte ndryshuar mendje gjithashtu, pasi ai tani ishte një blerës potencial i tokave nga terreni i përbashkët, pronë e shtetit.

- Po çmimi? - pyeti lensmandi.

- Pesëdhjetë dalerë është më e shumta që ata, me të drejtë, mund të kërkojnë nga çdo blerës, - u përgjigj eksperti.

Lensmandi e formuloi këtë përgjigje me një stil të ekzagjeruar.

6

Demi duhej hequr. Tashmë i rritur kushtonte shumë për t'u ushqyer; Isaku duhet ta çonte në fshat, për ta shitur e për të marrë një tjetër më pak të fuqishëm në këmbim.

Kjo ishte ideja e Ingerit. Dhe Ingeri kishte, pa dyshim, arsyet e saj për ta larguar Isakun nga shtëpia në atë ditë të veçantë.

Ingeri u ul në pragun e derës. Kishte shumë dhimbje sërish dhe faqet i kishte prush. Kishte qëndruar në këmbë derisa Isaku ishte larguar; tani ai dhe demi ishin larg syve dhe ajo mund t'i linte pa frikë vend një rënkimi. Eleseusi i vogël kishte filluar të fliste dhe e pyeti:

- Mama dhemb?

- Po, dhemb.

Ai imiton gjestet e së ëmës, duke vënë duart në bel e duke rënkuar. Siverti ishte në gjumë.

Ingeri e fut Eleseusin në shtëpi, i jep disa gjëra për të luajtur në dysheme, dhe vetë futet në shtrat. Koha e saj erdhi.

Ajo është krejtësisht e vetëdijshme gjatë gjithë kohës, e mban një sy nga Eleseusi, e shikon orën në mur herë pas here. Nuk bërtet, nuk lëviz; lufta është brenda saj - një

ngarkesë çlirohet dhe rrëshqet prej saj. Pothuajse në të njëjtin moment ajo dëgjon një klithmë të çuditshme në shtrat, një zë i vogël, i bekuar; zë i vogël, zë i vogël... dhe tani ajo nuk mund të durojë, do ta shohë. Çfarë sheh? Fytyra e saj zbehet, pa shprehje; dëgjohet një rënkim; i panatyrshëm, kafshëror, i pikëlluar.

Ajo shtrihet sërish në krevat. Minutat kalojnë; ajo nuk mund të qetësohet, të qarat e foshnjës jehojnë, ajo ngrihet sërish dhe e vështron... Oh, Perëndi! Përse? Nuk ka shpresa! E për më tepër, foshnja është vajzë!

Isaku nuk kishte bërë më shumë se nja dy kilometra. Kishin kaluar pak orë qëkur ai ishte larguar. Në më pak se dhjetë minuta Ingeri kishte lindur fëmijën dhe e kishte vrarë atë....

Isaku u kthye pas tri ditësh, duke udhëhequr një dem kockë e lëkurë saqë mezi e mbanin këmbët.

- Thirri fëmijët të vinin për ta parë.

Kafsha e re nxiste kureshtjen e të gjithëve. Ingeri e vëzhgoi mirë dhe pyeti se sa kishte kushtuar; Sivertit të vogël iu lejua të ulej në shpinën e tij.

- Do të më marrë malli për tjetrin, - tha Ingeri. - Ishte shumë i bukur dhe i mirë. Shpresoj se ata nuk do ta bëjnë të vuajë në thertore.

Ishte sezoni i mbjelljeve, dhe kishte mjaft punë. Kafshët u lanë të lirshme; Isaku mbolli më shumë grurë këtë vit sesa vitin e kaluar, bëri shtretër për karotat dhe rrepat, ndërsa Ingeri mbolli farat. Gjithçka vazhdoi si më parë.

Ingeri mbajti për ca kohë një qese sanë nën fustan, për të fshehur çdo ndryshim në pamjen e saj, duke hequr pak nga

pak, derisa e hoqi qesen krejt. Më në fund, një ditë, Isaku vuri re diçka dhe e pyeti i befasuar:

- Si është e mundur? Nuk kishte gjë këtë herë? Unë mendova se...

- Jo, këtë herë, jo.

- Ah. Pse, çfarë ndodhi?

- Kështu ishte e shkruar. Isak, mendon se do ta punosh të gjithë këtë tokë?

- Do të vësh bast?

- Po.

- Por... nuk je e sëmurë?

- Jo. Isak, unë kam menduar shpesh se duhet të kemi një derr.

- Po, mirë është të kesh një derr. Por nuk kemi mjaftueshëm patate. Të shohim vitin e ardhshëm.

Ditët kalojnë, shiu vjen, fushat dhe livadhet duken mirë, stinët po ashtu të mbara! Ngjarje të vogla dhe të mëdha, të zakonshme për ta: ushqim, gjumë dhe punë; të dielave, Isaku lante fytyrën e krihte flokët, dhe i veshur me një këmishë të re të kuqe ulej përballë Ingerit që qepte.

Në kohën e ngadaltë midis stinëve, Isaku priste pemët për të shtuar stokun e tij. Gjithashtu ai sapo të gjente gurë me madhësinë e duhur i sillte në fermë për t'i vendosur ne grumbullin e gurëve të tjerë, të cilët do të shërbenin për ngritjen e një muri. Një vit më parë, Ingeri do të kishte qenë kureshtarë, duke pyetur veten se çfarë ishte duke bërë - tani, ajo ishte e zhytur në punët e saj dhe nuk i bënte asnjë pyetje. Ishte e zënë me punë, në shtëpi, me fëmijët, në stallë. Tashmë ka filluar të këndojë, që është diçka e re, dhe ajo po i mëson

Elseusit një lutje për në mbrëmje; kjo gjithashtu është diçka e re. Isakut i mungon marrja në pyetje; ishte kureshtja dhe lavdërimi i saj për gjithçka që bënte, që e kënaqte dhe e nxiste atë, që e bënte njeri të pakrahasueshëm. Por tani, ajo kalonte duke mos thënë asgjë, pa i thënë se po punon deri në sflitje.

- Ajo është e trazuar nga hera e fundit, - mendonte Isaku me vete.

Oline erdhi për t'i vizituar edhe një herë. Nëse të gjithë do të kishin qenë si më parë, ajo do të ishte e mirëpritur, por tani ishte ndryshe. Ingeri e priti më me pak dëshirë; tashmë ajo e shikonte si një armike.

- Mendova të vij përsëri në kohën e duhur, - tha Oline, me nënkuptim.

- Çfarë do të thuash?

- Për të tretin që të pagëzohet.

- Qenke munduar kot, - ia ktheu Ingeri.

Oline lavdëroi fëmijët, aq të shëndetshëm dhe të rritur tashmë; dhe Isakun që hapte tokë dhe që do të ndërtonte përsëri.

- Dhe çfarë do të ndërtojë këtë herë?

- Pyete vetë, ia preu Ingeri. Unë nuk e di.

- Jo, tha Oline. Nuk është se më intereson. Unë thjesht erdha për të parë se si ishit; është një kënaqësi që ju gjej të lumtur. Sa për Briartën e kotë që të pyes dhe as flas për të - ajo është në duar më se të sigurta.

Ato folën gjatë; Ingeri nuk ishte më e ashpër. Ora në mur tingëlloi ëmbël. Oline, me lot në sy, i tha se kurrë në gjithë jetën e saj të përulur nuk e kishte dëgjuar një gjë të